



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 150

Tiranë – E premte, 23 gusht 2024

PËRMBAJTJA

Vendim i Gjykatës Evropiane
të të Drejtave të Njeriut
datë 7.5.2024

Çështja Biba kundër Shqipërisë (*kërkesa nr. 24228/18*).....

Faqe

18701



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA BIBA KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 24228/18)

VENDIM

Neni 8 • Detyrime pozitive • Jeta private • Rrëzimi i pretendimit të kërkuarit për dëmshpërblim për dëmin e rëndë që pësoi i biri kur u godit nga një nxënës tjetër me katapultë llastiku në një shkollë private gjatë një pushimi mes orëve të mësimi • Institucionet arsimore në parim kanë detyrimin të mbikëqyrin nxënësit gjatë të gjithë kohës që kalojnë në kujdesin e tyre, përfshirë pushimet në mes të orëve dhe prej tyre pritet të marrin masat e duhura për të parandaluar sjelljen e sendeve të rrezikshme nga nxënësit në ambientet e shkollës ose në mbikëqyrje • Mostrajtimi i duhur nga gjykatat e brendshme i pretendimeve faktike të kërkuarit, në lidhje me ngjarje që i paraprijnë dhe pasojnë incidentin • Mjeti juridik civil në dispozicion nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme ndaj sulmit ndaj integritetit fizik të djalit të kërkuarit • Fëmijët dhe personat e cënueshëm kanë të drejtë për mbrojtje efektive nga autoritetet • Mekanizmat e brendshëm ligjorë të përdorur në mënyrë të gabuar

Neni 6 § 1 (aspekti civil) • Privimi i aksesit në gjykatë për shkak të rrëzimit të ankimit kushtetues për shkak të depozitimit jashtë afatit kohor katërmujor të llogaritur nga data e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data e njoftimit të vendimit

Përgatitur nga Zyra e Kancelarit. Nuk është i detyrueshëm për Gjykatën.

STRASBURG
7 maj 2024

Ky vendim do të bëhet përfundimtar në rrethanat e përvakthuara në paragrafin 2 të nenit të Konventës. Mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Biba kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komiteti i përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *President,*

Jolien Schukking,

Georgios A. Serghides,

Darian Pavli,

Peeter Roosma,

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Milan Blaško, *kancelar Seksioni,*

duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 24228/18) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) nga një shtetas shqiptar, z. Tonin Biba (kërkuari), më 15 maj 2018;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë (Qeveria) për ankimin sipas neneve 3 dhe 8 të Konventës, që shteti nuk kishte përmbushur detyrimet e tij pozitive në një situatë dhune të shkaktuar ndaj djalit të kërkuarit nga shoku i tij i shkollës dhe dy ankime, sipas paragrafit 1, të nenit 6 që kohëzgjatja e proceseve civile ku kërkuari kërkonte dëmshpërblim për dëmin ndaj djalit të tij ishte e tejkaluar dhe që kërkuarit nuk i ishte dhënë e drejta e aksesit në Gjykatën Kushtetuese;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 5 dhe 26 mars 2024,

merr vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në datën e treguar më sipër:

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me detyrimet pozitive të shtetit, sipas nenit 8 të Konventës, për mënyrën e zbatimit të mekanizmave të brendshëm ligjorë nga autoritetet e brendshme, në lidhje me një sulm ndaj djalit të kërkuarit nga një nxënës tjetër në një shkollë private të frekuentuar nga ata të dy. Gjithashtu, ka të bëjë me kohëzgjatjen e procesit civil për dëmshpërblim në këtë drejtim dhe të drejtën e kërkuarit për akses në Gjykatën Kushtetuese, ku të dyja janë objekt i ankimit të kërkuarit, sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës.

FAKTET

2. Kërkuari ka lindur në vitin 1968 dhe jeton në Nju Jork, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kërkuari u përfaqësua nga z. N. Progri, avokat i licencuar në Tiranë.



3. Qeveria u përfaqësua nga agjenti i saj në atë kohë, z. O. Moçka, Avokat i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmbliidhen si më poshtë.

5. Në vitin 2011, D. B, djali i kërkuarit, i lindur më 6 qershor 2000, frekuentonte një shkollë private në Tiranë, “Ylber”. Më 20 shtator 2011, rreth orës 11:45 paradite ai u godit në syrin e djathtë me një objekt i fortë të lëshuar me katapultë llastiku të përdorur nga një nxënës tjetër, M. Sh, i cili në atë kohë akoma nuk i kishte mbushur 14 vjeç. Për rrjedhojë, djali i kërkuarit pësoi humbje të shikimit në syrin e djathtë në masën 90%.

6. Më 16 dhjetor 2011, kërkuari ngriti padi civile për dëmshpërblim në Gjykatën e Rrethit Tiranë kundër shkollës në emër të tij, por për djalin e tij, duke kërkuar dëmshpërblim për dëmin që pësoi djali i tij (90% humbje e shikimit të syrit të djathtë) në shumën 1 526 585 lekë (LEK), të përlllogaritur në bazë të raportit të ekspertit dhe që përfshinte dëmin jopasuror në shumën 157 700 lekë dhe dëmin pasuror në shumën 1 368 885 lekë.

Kërkuari pretendoi se autoritetet e shkollës ishin përgjegjëse sepse nuk arritën të mbronin djalin e tij nga sulmi nga një nxënës tjetër dhe nuk reagon si duhej ndaj incidentit.

Kërkuari pretendoi se shkolla mbante përgjegjësinë e vetme për këtë dëm, pasi nuk kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dëmin ndaj djalit të tij. Kërkuari pretendoi se një nxënës kishte sjellë njëzet katapulta në shkollë dhe i kishte shpërndarë mes nxënësve të klasës së djalit të kërkuarit dhe klasave të tjera, dhe se ato ishin përdorur për disa ditë në mjediset e shkollës pa kufizim dhe se askush nuk kishte bërë asgjë për këtë fakt. Ky mosrespektim i rregullores dhe disiplinës në shkollë kishte rezultuar në sulmin ndaj djalit të tij. Kërkuari pretendoi se nxënësi që kishte plagosur djalin e tij ishte i mitur, të cilin prindërit e tij ia kishin besuar shkollës gjatë orëve të mësimi dhe që rrjedhimisht kishte qenë nën mbikëqyrjen e shkollës.

Shkolla nuk kishte ofruar ndihmën e parë të duhur për djalin e tij. Kërkuari pretendoi se autoritetet e shkollës nuk e kishin informuar menjëherë për incidentin, edhe pse vajza e tij, e cila frekuentonte të njëjtën shkollë, kishte insistuar që ta njoftonin. Kërkuari kishte marrë dijeni për gjendjen e djalit të tij vetëm pasi e kishte marrë nga shkolla në orën 13:00, në orarin e zakonshëm, dhe më pas e kishte çuar në spitalin më të afërt. Mungesa e

ndihmës së parë të menjëhershme e kishte përkeqësuar gjendjen shëndetësore të djalit të tij.

Ai, gjithashtu, pretendoi se pas incidentit askush nga administrata e shkollës nuk kishte bërë asnjë hetim për gjendjen e djalit të tij, duke treguar kështu indiferencë ndaj ngjarjes së rëndë.

Kostoja e trajtimit mjekësor ishte paguar nga sigurimi familjar i kërkuarit. Kërkuari pretendoi se ai i ishte drejtuar shkollës së djalit të tij dhe i kishte kërkuar administratës së saj të mbulonte shpenzimet mjekësore dhe të paguante dëmshpërblim, por ata e kishin referuar atë te kompania e sigurimit të shkollës.

Ai më tej pretendoi se sekretariati i shkollës i kishte mohuar njohjen me rregullat dhe rregulloret e saj.

Bazuar në nenet 609, 640 dhe 641 të Kodit Civil, kërkuari pretendoi se dështimi i shkollës për të mbrojtur djalin e tij në kundërshtim me ligjin dhe rregullat administrative, dhe arsimore të shkollës sillte përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të shkollës për dëmin e pësuar nga djali i tij. Ai pohoi, gjithashtu, se shkolla kishte shkelur kontratën e pranimi të nënshkruar nga prindërit dhe shkolla në fillim të çdo viti shkollor.

7. Më 21 janar 2013, Gjykata e Rrethit Tiranë rrëzoi pretendimin e kërkuarit për dëmshpërblim ndaj shkollës me arsyetimin se dëmi i shkaktuar djalit të kërkuarit nuk ishte shkaktuar nga i pandehuri, por nga një palë e tretë. Sipas Gjykatës së Rrethit, nuk kishte asnjë lidhje shkakësore ndërmjet dëmit të pësuar nga djali i kërkuarit dhe veprimeve ose mosveprimeve të shkollës. Prandaj, i pandehuri nuk ishte përgjegjës. Më tej, ajo u shpreh se shkolla kishte bërë sigurim të palës së tretë që mbulonte të gjithë nxënësit e saj dhe se kërkuari duhej të kishte ngritur një padi civile kundër shoqërisë së sigurimit.

Gjykata e Rrethit gjeti se shkolla kishte marrë masa pas incidentit “për të siguruar shërbime më të mira kujdesi dhe shëndetësore” për djalin e kërkuarit “duke mbledhur fonde nga prindërit e nxënësve të tjerë dhe kishte kontaktuar kompaninë e sigurimeve SIGAL, duke i kërkuar asaj të mbulonte dëmshpërblimin dhe koston e trajtimit mjekësor” të djalit të kërkuarit, por që kërkuari kishte refuzuar të pranonte ndonjë prej tyre.

Dëmtimi i djalit të kërkuarit ishte shkaktuar nga M. Sh., një nxënës i mitur, dhe për këtë arsye prindërit e tij ishin drejtpërdrejt përgjegjës për të paguar dëmshpërblim për dëmin. Në fakt, ata i



kishin ofruar dëmshpërblim kërkuarit, por ai e kishte refuzuar.

Gjykata e Rrethit u shpreh më tej se shkolla nuk kishte marrë përsipër asnjë detyrim ligjor për të mbuluar shpenzimet mjekësore, në kundërshtim me atë që pretendohet nga kërkuari, në kontratën e pranimit të lidhur ndërmjet kërkuarit dhe shkollës. Kontrata e pranimit nuk kishte parashikuar përgjegjësinë e shkollës për ndonjë dëm që mund t'u ndodhte nxënësve gjatë qëndrimit të tyre në shkollë.

8. Më 31 janar 2013, kërkuari depozitoi një ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Përveç argumenteve që ai kishte ngritur para Gjykatës së Rrethit Tiranë, ai, gjithashtu, u shpreh se djali i tij kishte qenë në kujdestarinë e shkollës kur kishte ndodhur ngjarja dhe se kjo ishte e mjaftueshme për të vendosur një lidhje shkakësore ndërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të shkollës, dhe dëmit të pësuar nga djali i tij.

Ai pretendoi se ishin plotësuar të gjitha kushtet për përgjegjësinë e shkollës. Sa i përket ekzistencës së dëmit faktik, ai argumentoi se ishte vërtetuar me akt ekspertizë. Sa i përket veprimit të paligjshëm, ai argumentoi se shkolla i kishte lejuar nxënësit për shumë ditë të mbanin pajisje të rrezikshme, përkatësisht katapultë llastiku, me njërin prej të cilave ishte plagosur djali i tij. Shkolla kishte faj sepse djali i tij ishte plagosur kur ishte në ambientet dhe kujdestarinë e shkollës. Ai, gjithashtu, argumentoi se kishte pasur një lidhje shkakësore ndërmjet dëmit që kishte pësuar djali i tij dhe mosveprimit të shkollës.

Ai kishte nënshkruar vetëm një kontratë pranimi me shkollën, jo një kontratë me kompaninë e sigurimit. Me nënshkrimin e kontratës së pranimit, ai ia kishte besuar djalit të tij shkollën dhe shkolla kishte marrë përsipër detyrimin për të garantuar sigurinë e djalit të tij në shkollë. Ai u shpreh se shkolla ushtronte veprimtari arsimore në bazë të urdhrit të ministrit të Arsimit nr. 58, të 24 qershorit 1999 dhe, si i tillë, ishte e detyruar të respektoje legjislacionin e brendshëm dhe nuk ishte e përjashtuar nga përgjegjësia për shkelje të ligjit.

Për sa i përket kontratës me shoqërinë e sigurimit, kërkuari parashittoi se djali i tij ishte i mitur dhe ai nuk mund të kishte qenë palë në asnjë kontratë me shoqërinë e sigurimit. Përveç kësaj, ishte shkolla ajo që mund të kishte kërkuar dëmshpërblim nga kompania e sigurimit dhe jo kërkuari apo djali i tij. Kërkuari argumentoi gjithashtu se i pandehuri mund të kishte ftuar

kompaninë e vet të sigurimit si të bashkëpandehur në proces.

Për sa i përket ofertës së dëmshpërblimit nga prindërit e M. Sh., kërkuari pretendoi se ai nuk kishte marrë kurrë një ofertë të tillë. Ai nuk u kishte kërkuar asgjë atyre sepse marrëdhënia e tij kontraktuale ishte me shkollën.

Në lidhje me përgjegjësinë e shkollës, kërkuari u mbështet në nenet 608(1), 609(1), 625(1), 640 dhe 641 të Kodit Civil.

9. Më 1 prill 2014, Gjykata e Apelit Tiranë rrëzoi ankimin e kërkuarit dhe la në fuqi vendimin e shkollës së parë, duke miratuar konstatimet e saj të faktit. Ajo u shpreh se, që shkolla të mbahej përgjegjëse për dëmin e shkaktuar djalit të kërkuarit, duhet të plotësoheshin katër kushte në mënyrë kumulative: duhet të kishte humbje financiare, një veprim ose mosveprim të paligjshëm, faj dhe një lidhje shkakësore.

Për sa i përket çështjes së kërkuarit, ajo vuri në dukje se mungonte lidhja shkakësore, mungonte ndërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të shkollës, dhe dëmit të pësuar nga djali i kërkuarit. Gjithashtu, shkolla nuk kishte kryer asnjë faj. Në lidhje me këtë, Gjykata e Apelit shpjegoi se do të kishte qenë e pamundur që shkolla t'i ndalonte nxënësit të mbanin llastikë sepse ato përdoren për të siguruar kartëmonedhat e mbështjella dhe nuk ishin të ndaluara në shkollë. Për këtë arsye, autoritetet e shkollës nuk kanë mundur të parashikojnë se mund të ndodhë një incident i tillë. Për më tepër, edhe pse incidenti kishte ndodhur kur djali i kërkuarit ishte në shkollë, ai ndodhi gjatë një pushimi kur ai kishte dalë nga klasa për t'u nisur për në klasën e edukimit fizik, në një kohë kur nxënësit nuk kishin qenë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të një mësuesi, dhe për këtë arsye shkolla nuk mund të mbante përgjegjësi për veprimet e nxënësve të saj. Megjithatë, Gjykata e Apelit nuk u pajtua me arsyetimin e Gjykatës së Rrethit, në lidhje me kontratën e pranimit, duke gjetur se kontrata nuk mund të përjashtonte përgjegjësinë e shkollës. Meqë kontrata nuk mund të parashikonte të gjithë skenarët hipotetikë, zgjidhja e ngjarjeve të paparashikuara rregullohet nga dispozitat e përgjithshme të Kodit Civil për përgjegjësinë për dëmin.

Shkolla kishte sigurim që mbulonte të gjithë nxënësit e saj dhe mbi këtë bazë kërkuari kishte të drejtë të kërkonte dëmshpërblim nga kompania e sigurimit, por kishte refuzuar ta bënte këtë.



Gjithashtu, prindërit e M. Sh. ishin përgjegjës për veprimet e djalit të tyre sipas nenit 613 të Kodit Civil.

Për sa i përket asaj që kishte bërë shkolla pas incidentit, Gjykata e Apelit vendosi që shkolla “mori masa pas incidentit për të siguruar kujdesin dhe trajtimin më të mirë mjekësor” për djalë të kerkuesit dhe, gjithashtu, mbledhi donacione nga prindërit e nxënësve të tjerë dhe kontaktoi kompaninë e sigurimeve, për të siguruar që të mbulohej kostoja e trajtimit mjekësor të djalit të kerkuesit në një “institucion serioz shëndetësor”.

10. Më 31 janar 2013, kerkuesi depozitoi një ankim të mëtejshëm në Gjykatën e Lartë. Ai pretendoi, në veçanti, se incidenti në fjalë kishte ndodhur në ambientet e shkollës dhe se shkolla ishte e detyruar me ligj të parandalonte një incident të tillë.

11. Më 26 shtator 2017, Gjykata e Lartë, me detyrë të mbyllura, pa praninë e kerkuesit ose avokatit të tij, rrëzoi ankimin e kerkuesit me arsyetimin se sipas nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata e Lartë mund të vlerësonte në themel ankimin kundër një vendimi të Gjykatës së Apelit vetëm nëse vëren zbatim të gabuar të së drejtës materiale ose procedurale. Gjykata e Lartë vlerësoi se arsyet e ankimit të kerkuesit nuk i plotësonin këto kërkesa.

12. Vendimi i Gjykatës së Lartë iu dorëzua kerkuesit më 10 janar 2018, datë në të cilën kerkuesi mori dijeni për arsyet e atij vendimi.

13. Më 8 shkurt 2018, kerkuesi depozitoi një ankim kushtetues në Gjykatën Kushtetuese. Bazuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13, të Konventës, si dhe nenin 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, ai u ankua se vendimet e gjykatave më të ulëta nuk kishin arsye të mjaftueshme dhe nuk kishin marrë parasysh interesin më të lartë të djalit të tij. Në veçanti, ai kundërshtoi përfundimin e gjykatave më të ulëta se shkolla nuk kishte qenë përgjegjëse për dëmin e pësuar nga djali të tij dhe pretendoi se shkolla ishte përgjegjëse për çdo dëm të shkaktuar fëmijëve të mitur në mjediset e shkollës dhe për sa kohë që ata ishin nën kujdesin e shkollës. Ai, gjithashtu, pretendoi që shkolla kishte detyrimin të merrte të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar incidentin në fjalë.

14. Më 15 shkurt 2018, Gjykata Kushtetuese e shpalli të papranueshëm ankimin e kerkuesit, sepse ai ishte depozituar jashtë afatit ligjor katërmujor, i cili kishte filluar të numërohej më 26 shtator 2017, kur Gjykata e Lartë mori vendimin e ankimit.

15. Më 19 nëntor 2021, kerkuesi dorëzoi në Gjykatë një autorizim të nënshkruar nga djali i tij për t'u përfaqësuar para Gjykatës nga kerkuesi dhe z. Progri (shihni paragrafin 2 më lart).

LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

I. KUSHTETUTA

16. Pjesa përkatëse e nenit 54 të Kushtetutës lexon:

“Neni 54

1. Fëmijët, të rinjtë, kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.

...

3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi.....”.

II. LIGJI PËR GJYKATËN KUSHTETUESE

17. Ligji nr. 99/2016, i 6 nëntorit 2016, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 210, më 8 nëntor 2016, ndryshoi Ligjin për Gjykatën Kushtetuese. Neni 30 u shfuqizua. Neni i ri 71(a), i sapo prezantuar, shkurtoi afatin për depozitimin e një ankimi kushtetues individual nga dy vjet në katër muaj “nga konstatimi i cenimit [të të drejtës ose lirisë kushtetuese]” (*konstatimi i cënimit*). Neni 86(3), i ligjit nr. 99/2016, parashikon që neni 71(a), i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese duhet të hyjë në fuqi më 1 mars 2017. Ligji nr. 99/2016 ka hyrë në fuqi ditën e pesëmbëdhjetë pas botimit në Fletoren Zyrtare (neni 88), pra më 23 nëntor 2016.

III. KODI CIVIL

18. Pjesa përkatëse e Kodit Civil parashikon:

“TITULLI IV DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA SHKAKTIMI I DËMIT

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËRGJEGJËSIA PËR SHKAKTIMIN E DËMIT

Neni 608

Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave



dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.

Neni 609

Dëmshpërblimi duhet të jetë i pagueshëm për dëmin që është rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit që ka shkaktuar dëmin. Mospengimi i një ngjarjeje nga personi ka detyrimin ligjor për ta mënjanuar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.

...

Neni 613

Dëmi nga të miturit dhe personat e pazotë për të vepruar

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç dhe personat që janë krejt të pazotë për të vepruar nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar.

Prindërit, kujdestari ose ata të cilëve u janë besuar ose kanë në mbikëqyrje persona të pazotë për të vepruar, janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga veprimet e paligjshme të fëmijëve nën moshën katërmëdhjetë vjeç, të personave nën kujdestarinë e tyre dhe të atyre që i kanë nën mbikëqyrje e me të cilët banojnë, por që nuk kanë zotësi për të vepruar, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

Neni 614

I mituri që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, përgjigjet për dëmin e paligjshëm të shkaktuar prej tij.

Prindërit ose kujdestari përgjigjen për dëmin e mësipërm kur i mituri nuk nxjerr të ardhura nga puna ose nuk ka vetë pasuri, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

Neni 615

Dëmi nga personat nën mbikëqyrje

Mësuesit dhe personat e tjerë që kanë nën mbikëqyrje të mitur ose personat që u mësojnë të tjerëve një mjeshtëri ose profesion, janë përgjegjës për dëmin e paligjshëm të shkaktuar të tjerëve nga nxënësit ose personat që kanë nën mbikëqyrje, ose personat që mësojnë mjeshtëri apo profesion pranë tyre, të shkaktuar gjatë kohës që kanë qenë nën mbikëqyrje të tyre të drejtpërdrejtë, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

...

KREU III SHPËRBLIMI I DËMIT

Neni 640

Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar. Shpërblehen gjithashtu shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur ose pakësuar dëmin, ato që kanë qenë të nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe masën e dëmit, si dhe shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore.

Neni 641

Personi që i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij, detyrohet ta shpërblejë dëmin, duke pasur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë të të dëmtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar.”

IV. KODI I PROCEDURËS CIVILE

19. Neni 192 parashikon që secila palë mund të thërrasë në gjykimin e çështjes një person me të cilin mendon se e ka të përbashkët çështjen ose nga i cili mund të kërkohej një garanci, ose shpërblim, që lidhet me përfundimin e çështjes.

20. Neni 195, gjithashtu, bën të mundur që një person i tretë, me pëlqimin e të dyja palëve, mund të zërë vendin e palës në proces.

21. Më 30 mars 2017 u miratua ligji nr. 38/2017. Ai hyri në fuqi më 6 nëntor 2017 dhe prezantoi ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile. Neni 399 i atij ligji prezantoi një mjet të ri juridik për procese civile të zvarritura, duke mundësuar përsheptimin e procedurave dhe pagimin e shpërblimit. Ai vendosi një maksimum prej dy vitesh për gjykimin e një çështjeje civile në çdo gjykatë të shkallës së parë, gjykatë apeli dhe Gjykatë të Lartë. Procesi për të kërkuar këtë mjet ishte depozitimi i një kërkesë në një gjykatë më të lartë dhe në rastin e Gjykatës së Lartë, në një Kolegj të ndryshëm të asaj gjykate.

V. LIGJI Nr. 7952, PËR INSTITUCIONET ARSIMORE

22. Ligji nr. 7952, “Për sistemin e arsimit parauniversitar”, u miratua më 21 qershor 1995 dhe u ndryshua me ligjin nr. 8337, datë 30 korrik 1998; ligjin nr. 8872, datë 29 mars 2002; ligjin nr. 9903, datë 17 prill 2008; dhe ligjin nr. 9985, datë 11 shtator 2008.



23. Neni 44, i ligjit nr. 7952, lejon Ministrinë e Arsimit dhe Shkencave të lëshojë licenca për institucione arsimore private ku mësimdhënia zhvillohet në gjuhën shqipe. Këto licenca jepen kur planet [strategjike], programet arsimore dhe kushtet për realizimin e tyre nuk bien ndesh me interesin kombëtar shqiptar ose me legjislacionin, rendin publik, normat morale dhe sigurinë publike, dhe kur janë në dispozicion burimet e nevojshme dhe stafi mësimor. Kriteret dhe procedurat për licencimin e shkollave laike private në të cilat mësimi është në gjuhën shqipe rregullohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Nëse këto rregullore shkelen nga një institucion i tillë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës mund të tërheqë licencën e saj.

24. Neni 46 parashikon që, për të marrë një licencë, institucionet private arsimore duhet të dëshmojnë se kanë staf pedagogjik me arsimin përkatës dhe kualifikimet e duhura, dhe se ato janë të pajisura me burime mësimore të përshtatshme për kërkesat e planit të tyre [arsimor] dhe programet mësimore.

25. Neni 66 parashikon që shteti duhet të garantojë sigurinë e mësuesve dhe studentëve, si edhe sigurinë e institucioneve arsimore dhe ambienteve të tyre.

VI. LIGJI NR. 10433 (2011), PËR INSPEKTIMET [ADMINISTRATIVE]

26. Ligji nr. 10433 hyri në fuqi, për pjesën më të madhe të tij, më 20 korrik 2011. Prandaj ishte në fuqi në pjesët përkatëse ditën që ngjarja në shkollë çoi në këtë çështje, dhe ishte detyrues për Inspektoratin e Ministrisë së Arsimit, përgjegjës për kontrollin e shkollave private.

27. Sipas nenit 25, të ligjit nr. 10433, një inspektim i rastësishëm i një subjekti përkatës mund të kryhet kur konsiderohet i nevojshëm në bazë të informacionit të dhënë nga një organ tjetër shtetëror ose kur ngjarje, aksidente, ose incidente të veçanta kanë ndikuar, ose rrezikojnë të ndikojnë në jetën ose shëndetin e njerëzve. Ky inspektim mund të autorizohet, gjithashtu, në bazë të një ankese ose informacioni të dhënë nga palë të treta [private], të cilat lindin dyshimin e arsyeshem se një subjekt [që i nënshtrohet ligjeve të inspektimit] mund të ketë shkelur kërkesat ligjore.

LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR PËR-KATËS

KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS, E 20 NËNTORIT 1989

28. Pjesa përkatëse e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (e ratifikuar nga Shqipëria më 27 shkurt 1992) lexon si më poshtë:

“Neni 3

1. Në të gjitha masat që kanë të bëjnë me fëmijët, të marra nga institucione publike ose private të përkrahjes sociale, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, konsiderata mbizotëruese duhet të jetë interesi më i lartë i fëmijës.

(...)

3. Shtetet Palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.

Neni 19

1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.

2. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, në se duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.”

LEGJISLACIONI

I. LEGJITIMIMI I KËRKUESIT

29. Çështja e parë për t'u vendosur është nëse kërkesi kishte të drejtë të paraqiste një kërkesë në emër të tij për një shkelje të pretenduar të të drejtave të djalit të tij.



30. Qeveria argumentoi se të drejtat sipas nenit 8 të Konventës ishin të një natyre jashtëzakonisht personale dhe nuk mund të transferoheshin te një person tjetër. Sipas mendimit të tyre, kërkuesi kishte ngritur një padi civile në gjykatat e brendshme vetëm si babai i një viktime. Djali i kërkuesit, viktimja e drejtpërdrejtë, nuk vuante nga ndonjë paaftësi dhe kishte zotësi juridike për të shprehur vullnetin e tij. Qeveria pretendoi se kërkuesi kishte vepruar vetëm si përfaqësues i djalit të tij dhe nuk mund të kishte statusin e vetë viktimës. Djali i kërkuesit kishte mbushur moshën madhore në qershor 2018 dhe kështu kishte fituar zotësi të plotë juridike. Për më tepër, nuk kishte asnjë lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet vuajtjes së djalit të kërkuesit dhe kërkesës së paraqitur nga kërkuesi në emrin e tij.

31. Kërkuesi argumentoi se ai e kishte paraqitur kërkesën në emër të djalit të tij, siç kishte bërë në proceset e brendshme, dhe se, edhe kur djali i tij arriti moshën madhore, për shkak të aftësisë së tij të kufizuar, ai nuk kishte mundur të merrte pjesë në asnjë proces.

32. Në këtë pikë, Gjykata vëren se objekti dhe qëllimi i Konventës, si instrument për mbrojtjen e qenieve njerëzore individuale, kërkon që dispozitat e saj, si procedurale ashtu edhe materiale, të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrë që t'i bëjnë garancitë e saj praktike dhe efektive. Në këtë kontekst, pozicioni i fëmijëve, sipas nenit 34, kualifikohet për shqyrtim të kujdesshëm, pasi ata, në përgjithësi, duhet të mbështeten te personat e tjerë për të paraqitur pretendimet e tyre dhe për të përfaqësuar interesat e tyre, dhe mund të mos kenë moshën ose zotësinë për të autorizuar hapat që duhet të ndërmerren në emër të tyre në çdo kuptim real. Prandaj, një qasje kufizuese ose teknike në këtë fushë duhet të shmanget dhe konsiderata kryesore në raste të tilla është që çdo çështje serioze, në lidhje me respektimin e të drejtave të fëmijës, duhet të shqyrtohet (shihni *Tonchev kundër Bullgarisë*, nr. 18527/02, § 31, 19 nëntor 2009, me referenca të mëtejshme).

33. Gjykata ka trajtuar një situatë të ngjashme në disa çështje. Kështu, në çështjen e lartpërmendur *Tonchev* kërkesa është depozituar nga babai, në emër të tij, i një fëmije që u dëmtua nga një person privat. Gjykata e pranoi babanë si kërkues, duke qenë se fëmija kishte qenë i mitur në kohën e ngjarjeve, si edhe në kohën e depozitimit të kërkesës në Gjykatë dhe babai kishte nisur një proces gjyqësor të

brendshëm, në emër të djalit të tij (*idem.*, §§ 32 dhe 33). Gjykata doli në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të neneve 3 dhe 8 të Konventës, meqenëse “trajtimi objekt i ankimit nuk kishte efekte negative për integritetin fizik ose moral të djalit të kërkuesit” (*idem.*, §§ 41 dhe 42).

34. Në çështjen *M. S. kundër Ukrainës* (nr. 2091/13, 11 korrik 2017) kërkesa u paraqit edhe nga babai i një fëmije që dyshohej se ishte abuzuar seksualisht, në emër të tij dhe në emër të fëmijës. Në atë çështje, proceset e brendshme, përkatësisht kërkesa për kryerjen e një hetimi penal, u paraqit nga nëna e kërkuesit. Gjykata pranoi si kërkues të atin dhe fëmijën (*idem.*, §§ 51–53). Gjykata gjeti shkelje të nenit 8 të Konventës “për shkak të mungesës së një hetimi efektiv për abuzimin e dyshuar seksual të fëmijës së kërkuesit” (*idem.*, § 68) dhe për shkak të “përcaktimit të vendbanimit të fëmijës së kërkuesit” (*idem.*, § 86).

35. Në çështjen *Blyudik kundër Rusisë* (nr. 46401/08, 25 qershor 2019) kërkesa u paraqit, në emër të tij, nga babai, i cili ankohej, sipas neneve 5 dhe 8 të Konventës, për vendosjen e fëmijës në një institucion arsimor të mbyllur. Gjykata e pranoi babanë si kërkues, duke qenë se fëmija kishte qenë i mitur në kohën e procesit të brendshëm dhe në kohën e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë. Gjithashtu, babai kishte të drejtë të vepronte në emër të vajzës dhe të mbronte interesat e saj në bazë të Kodit të Familjes në Rusi, dhe ai kishte kërkuar që proceset e vlerësimit të mbikëqyrjes, në lidhje me vendosjen e fëmijës në institucionin në fjalë, të fillonin nga prokurori (*idem.*, §§ 41–44). Gjykata gjeti shkelje të paragrafit 5, të nenit 5 të Konventës, duke u shprehur se: “kërkuesi, duke vepruar në interes të vajzës së tij, nuk kishte ‘të drejtë të zbatueshme për kompensim’, sipas paragrafit 5, të nenit 5 të Konventës, për vendosjen e vajzës së tij në institucionin arsimor të mbyllur për të mitur” (*idem.*, § 64). Gjykata gjeti, gjithashtu, një shkelje të “së drejtës së kërkuesit dhe vajzës së tij për respektimin e jetës së tyre familjare, sipas nenit 8 të Konventës” (*idem.*, § 76).

36. Gjykata nuk sheh asnjë arsye për t'u larguar nga qasja e mësipërme në çështjen në fjalë. Në këtë drejtim, ajo vëren se në kohën e ngjarjeve në fjalë, si edhe kur u depozitua kërkesa, djali i kërkuesit ishte ende i mitur (shihni paragrafin 5 më sipër). Gjithashtu, ishte kërkuesi ai që filloi procesin e brendshëm (shihni paragrafin 6 më lart dhe



krahasoni *Tonchev*, cituar më lart, § 32). Për më tepër, me arritjen e moshës madhore, djali i kërkuessit autorizoi si kërkuessin ashtu edhe avokatin që përfaqësonte kërkuessin për ta përfaqësuar atë para Gjykatës (shihni paragrafin 15 më lart). Prandaj, nisur nga parimet e mësipërme, mund të nxirret përfundimi se kërkuessi kishte të drejtë t'i drejtohej Gjykatës për të mbrojtur interesat e djalit të tij.

37. Prandaj, Gjykata është e bindur që kërkuessi kishte të drejtë të paraqiste kërkesën në emër të djalit të tij (krahasoni çështjet e cituara më sipër *Tonchev*, § 33; *M.S.*, §§ 51–53; dhe *Blyudik*, §§ 41–44; si dhe *Caamaño Valle kundër Spanjës*, nr. 43564/17, §§ 33 dhe 34, 11 maj 2021).

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 8 TË KONVENTËS

38. Kërkuessi, mbështetur në nenet 3 dhe 8 të Konventës, u ankua se shteti nuk kishte përmbushur detyrimet e tij, në lidhje me incidentin ku djali i tij kishte pësuar një dëmtim të rëndë. Gjykata, duke qenë autoriteti i cilësimit juridik të fakteve të çështjes (shihni *Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë* [DHM], nr. 37685/10 dhe 22768/12, § 114, 20 mars 2018; shihni, gjithashtu, *Darboe dhe Camara kundër Italisë*, nr. 5797/17, § 111, 21 korrik 2022), do të shqyrtojë ankimin vetëm nga pikëpamja e nenit 8 të Konventës, pjesa përkatëse e të cilit lexon si më poshtë:

“Neni 8

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare.....

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

39. Qeveria argumentoi se kërkuessi nuk kishte ngritur asnjë çështje, sipas nenit 8 të Konventës, në gjykatat e brendshme. Ata pretenduan se kërkuessi kishte kërkuar vetëm kompensimin e dëmit para gjykatave të brendshme, duke pretenduar se: “dëmi i shkaktuar fëmijës tonë është pasojë e drejtpërdrejtë e mosveprimit të stafit drejtues të palës së paditur” dhe se pretendimi i tij kishte të bënte me dëmin pasuror. Ata, gjithashtu, argumentuan se para

Gjykatës Kushtetuese kërkuessi kishte ngritur vetëm ankime, në lidhje me procesin e rregullt ligjor dhe “paligjshmërinë e vendimeve të gjykatave”.

40. Kërkuessi i kundërshtoi këto argumente.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Zbatueshmëria e nenit 8 të Konventës

41. Më parë, në kontekste të ndryshme, Gjykata është shprehur se koncepti i jetës private është një term i gjerë që nuk i nënshtrohet një përkufizimi shterues. Ai përfshin integritetin fizik dhe psikologjik të një personi (shihni *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], nr. 76639/11, § 95, 25 shtator 2018; shihni, gjithashtu, *Remetin kundër Kroacisë*, nr. 29525/10, § 90, 11 dhjetor 2012). Megjithatë, Gjykata thekson se jo çdo veprim ose masë e një personi privat që ndikon negativisht në integritetin fizik dhe psikologjik të tjetrit ndërhyr në të drejtën për respektimin e jetës private të garantuar nga neni 8. Ajo thekson se një prag ashpërsie është i nevojshëm për zbatueshmërinë e nenit 8 në një situatë të tillë (shihni *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë* [DHM], nr. 41720/13, § 128, 25 qershor 2019, me referenca të mëtejshme).

42. Për sa i përket çështjes në fjalë, Gjykata vëren se mes palëve nuk vihet në diskutim që një nxënës tjetër në shkollën private të frekuentuar nga djali i kërkuessit kishte plagosur djalin e kërkuessit duke e gjuajtur në sy me objekt të fortë të lëshuar nga një katapultë dhe që kishte rezultuar në humbjen e shikimit në masën 90% në atë sy (shihni 5 paragrafin më lart). Natyra e këtyre pasojave është e tillë që ato, pa dyshim, kanë ndikuar në jetën e përditshme të djalit të kërkuessit që atëherë në një masë të tillë që kanë pasur një efekt negativ në jetën e tij private. Gjithashtu, duket se nuk ka asnjë arsye në parim që nocioni i “jetës private” të konsiderohet se përjashton sulmet ndaj integritetit fizik të dikujt (shihni *X dhe Y kundër Hollandës*, 26 mars 1985, § 23, seria A, nr. 91 *M. C kundër Bullgarisë* nr. 39272/98, § 150, GJEDNJ 2003 XII; *Sandra Janković kundër Kroacisë*, nr. 38478/05, §§ 30 dhe 31, 5 mars 2009; dhe *V. C. kundër Italisë*, nr. 54227/14, § 85, 1 shkurt 2018).

43. Prandaj, nisur nga natyra dhe thelbi i ankimeve të kërkuessit, ato duhet të shqyrtohen sipas nenit 8 të Konventës, i cili sjell detyrimin e shtetit për të mbrojtur integritetin fizik dhe psikologjik të një personi (shihni *A dhe B kundër Kroacisë*, nr. 7144/15, § 106, 20 qershor 2019, me referenca të mëtejshme).

**b) Shterimi i mjeteve juridike të brendshme**

44. Parimet e përgjithshme, në lidhje me shterimin e mjeteve juridike të brendshme, janë përcaktuar në *Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë* ([DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §§ 69–77, 25 mars 2014, dhe *Gherghina kundër Rumanisë* (vendim) [DHM], nr. 42219/07, §§ 83–89, 9 korrik 2015).

45. Gjykata ka vendosur, në veçanti, se detyrimi për të shteruar mjetet juridike të brendshme kërkon që kërkuesi të përdorë normalisht mjetet juridike që janë të disponueshme dhe të mjaftueshme, në lidhje me ankimet e tij/saj sipas Konventës (shihni *Vučković dhe të tjerët*, cituar më lart, § 71). Paragrafi 1, i nenit 35, gjithashtu, kërkon që ankimet që synohen të bëhen më pas përpara Gjykatës duhet t'i jenë paraqitur organit përkatës të brendshëm, të paktën në thelb (*idem.*, § 72).

46. Për sa i përket çështjes në fjalë, Gjykata vëren se kërkuesi zgjodhi të fillojë proces civil kundër shkollës që frekuentonte djali i tij. Kërkuesi kërkoj dëmshpërblim si për dëmin pasuror ashtu edhe për atë jopasuror. Ai argumentoi se shkolla nuk kishte arritur të mbronte djalin e tij dhe nuk kishte reaguar siç duhej ndaj incidentit (shihni paragrafët 6, 8 dhe 10 më lart).

47. Në ankimin e tij kushtetues, kërkuesi u ankua për gjetjet e gjykatave të brendshme se shkolla nuk kishte qenë përgjegjëse për dëmin që kishte pësuar djali i tij kur ai ishte në kujdesin e shkollës dhe në mjediset e shkollës.

48. Para Gjykatës kërkuesi solli të njëjtat argumente që kishte paraqitur në proces civil, domethënë, që shkolla nuk kishte bërë asgjë gjatë kohës që u finalizua me incidentin për të trajtuar problemin e katapultave në ambientet e shkollës, që rezultoi në plagosjen e rëndë të djalit të tij; që personeli i shkollës nuk kishte monitoruar sjelljen e nxënësve; dhe që reagimi i tyre pas incidentit kishte qenë i pamjaftueshëm, duke mos kërkuar menjëherë ndihmë mjekësore për djalin e tij dhe duke mos i informuar prindërit menjëherë (shihni paragrafët 6, 8 dhe 13 më lart).

49. Duke krahasuar argumentet e kërkuetit para gjykatave të brendshme me ankimet që ai paraqiti në Gjykatë, Gjykata vlerëson se kërkuesi e ngriti thelbin e ankimeve të tij, sipas nenit 8 të Konventës, para gjykatave të brendshme, duke përfshirë ankimin e tij kushtetues, edhe pse ai nuk u mbështetet shprehimisht në nenin 8 të Konventës.

50. Nga kjo rrjedh se kundërshtimi i Qeverisë për shterimin e mjeteve juridike të brendshme duhet të rrëzohet.

c) Konkluzione mbi pranueshmërinë

51. Gjykata vëren se ky ankim nuk është as haptazi i pabazuar dhe as i papranueshëm për ndonjë nga shkaqet e tjera të renditura në nenin 35 të Konventës. Prandaj, ai duhet të shpallet i pranueshëm.

B. Themeli**1. Parashtrimet e palëve**

52. Kërkuesi pretendoi se shteti kishte dështuar në mbikëqyrjen e duhur të një shkolle private të licencuar. Ai pretendoi se në ditën e incidentit djali i tij nuk kishte marrë asnjë ndihmë mjekësore ndërmjet orës 11:45 dhe 13:00, dhe se shkolla nuk e kishte informuar menjëherë që djali i tij ishte lënduar. Ai argumentoi se djali i tij kishte pasur dhimbje të mëdha dhe humbje afatgjatë të ekuilibrit dhe se nëse do të kishte pasur ndërhyrje të menjëhershme mjekësore, dëmi i përhershëm i pësuar nga djali i tij mund të ishte minimizuar.

53. Ai, më tej, argumentoi se shkolla ishte përgjegjëse për dëmtimin e djalit të tij, por, gjithashtu, ishte edhe shteti që kishte licencuar shkollën dhe kishte detyrimin ligjor për ta mbikëqyrur atë.

54. Ai, gjithashtu, kundërshtoi gjetjet e gjykatave kombëtare se shkolla nuk mbante asnjë përgjegjësi, pavarësisht nga fakti që gjykatat e brendshme kishin pranuar që djali i tij ishte lënduar gjatë ditës së shkollës. Ai parashtroi se gjykatat e brendshme nuk e kishin trajtuar argumentin e tij se një nxënës kishte sjellë njëzet katapulta në shkollë dhe se këto ishin përdorur “haptazi” nga nxënësit në mjediset e shkollës gjatë disa ditëve dhe se askush nuk e kishte kontrolluar apo ndaluar përdorimin e tyre.

55. Për sa i përket vendimit të gjykatave të brendshme, që ai duhet të kishte ngritur padi kundër shoqërisë së sigurimit të shkollës, kërkuesi parashtroi se shkolla, si i pandehur në procesin civil që kishte filluar, ishte e lirë që të ftonte shoqërinë e sigurimit të bashkohej në ato procese, sipas nenit 192 të Kodit të Procedurës Civile (shihni paragrafin 19 më lart).

56. Qeveria nuk u pajtua me pretendimet e kërkuetit dhe parashtroi se lëndimi i djalit të kërkuetit kishte qenë rezultat i një incidenti që kishte ndodhur ndërsa fëmijët po luanin në shkollë. Shkolla kishte marrë të gjitha masat e nevojshme, siç



janë fillimi i procedimit disiplinor ndaj fëmijës që kishte shkaktuar dëmin dhe asgjësimin e këtyre mjeteve në të ardhmen, pasi mund të përbënin rrezik potencial për fëmijët.

57. Qeveria argumentoi më tej se, në vend që të padiste shkollën, kërkuesi duhej të kishte ngritur një padi për dëmshpërblim kundër prindërve të nxënësit që i kishin shkaktuar dëmin djalit të tij. Ai mund të kishte kërkuar dëmshpërblim edhe nga kompania e sigurimeve me të cilën shkolla kishte siguruar të gjithë nxënësit e saj. Gjykatat kombëtare kishin dhënë arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre që rrëzonin pretendimin e kërkuesit.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parime të përgjithshme

58. Në çështjen *Durdević kundër Kroacisë* (nr. 52442/09, §§ 103–107, 18 tetor 2011) që ka të bëjë me dhunën ndaj nxënësve, Gjykata vendosi parimet e përgjithshme si më poshtë:

“103. Për sa i përket disiplinës në shkollë, Gjykata u shpreh si më poshtë në vendimin e saj, të cituar më sipër, në *Costello-Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

“27. Gjykata vëren fillimisht se, siç u theksua nga kërkuesi, Shteti ka detyrimin t’u sigurojë fëmijëve të drejtën e tyre për arsim sipas nenit 2, të Protokollit nr. 1. Ajo sjell në vëmendje që dispozitat e Konventës dhe Protokollit e saj duhet të lexohen në tërësi (shihni vendimin *Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, e 7 dhjetorit 1976, seria A, nr. 23, f. 26 dhe 27, para. 52 dhe 54, dhe vendimin *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar* e 7 korrikut 1989, seria A, nr. 161, f. 40, para. 103). Funksionet që lidhen me administrimin e brendshëm të një shkolle, siç është disiplina, nuk mund të thuhet se janë thjesht ndihmëse të procesit arsimor (shihni, *mutatis mutandis*, vendimin *Campbell dhe Cosans kundër Mbretërisë së Bashkuar* e 25 shkurtit 1982, seria A, nr. 48, f. 14, para. 33). Fakti që sistemi disiplinor i një shkolle përfshihet në fushën e së drejtës për arsim është njohur gjithashtu, më së fundi, në nenin 28 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, e datës 20 nëntor 1989, e cila hyri në fuqi më 2 shtator 1990 dhe u ratifikua nga Mbretëria e Bashkuar më 16 dhjetor 1991. Ky nen, në kuadër të së drejtës së fëmijës për arsim, lexon si më poshtë:

“2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin

njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë.”.

Së dyti, në Mbretërinë e Bashkuar, shkollat e pavarura ekzistojnë bashkë me sistemin e arsimit publik. E drejta themelore e çdokujt për arsim është një e drejtë e garantuar në mënyrë të barabartë për nxënësit në shkollat shtetërore dhe ato të pavarura, pa ndonjë dallim ndërmjet të dyjave (shihni, *mutatis mutandis*, vendimin e lartpërmendur *Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen*, seria A, nr. 23, f. 24, para. 50).

Së treti, Gjykata pajtohet me kërkuesin që Shteti nuk mund të zhvishet nga përgjegjësia duke i deleguar detyrimet e tij tek organet ose personat privatë (shihni, *mutatis mutandis*, vendimin *Van der Mussele kundër Belgjikës*, e 23 nëntorit 1983, seria A nr. 70, f. 14–15, para. 28–30).

28. Rrjedhimisht, në këtë çështje, e cila lidhet me fushën e caktuar të disiplinës shkollore, trajtimi për të cilin bëhet ankimi, megjithëse është veprim i drejtorit të një shkolle të pavarur, është gjithsesi i tillë që mund të përfshijë përgjegjësinë e Mbretërisë së Bashkuar sipas Konventës nëse rezulton se nuk është në përputhje me nenin 3 ose nenin 8 ose të dyja.

104. Gjykata vlerëson se e njëjta gjë vlen edhe për çështjet e disiplinës shkollore në marrëdhëniet ndërmjet nxënësve.

...

106. Ndërsa objekti thelbësor i nenit 8 është mbrojtja e individit nga ndërhyrjet arbitrare nga autoritetet publike, ai nuk e detyron Shtetin thjesht që të mos ndërhyjë: përveç kësaj ndërmarrjeje negative, mund të ketë detyrime pozitive të qenësishme për respektimin efektiv të jetës private apo familjare. Këto detyrime mund të përfshijnë miratimin e masave të krijuara për të siguruar respektimin e jetës private edhe në sferën e marrëdhënieve të individëve ndërmjet tyre (shihni *X dhe Y kundër Holandës*, 26 mars 1985, § 23, seria A, nr. 91; *Botta kundër Italisë*, 24 shkurt 1998, § 33, *Raportet e Vendimeve* 1998 I; *Mikulic*, cituar më lart, § 57; dhe *Sandra Janković kundër Kroacisë*, nr. 38478/05, § 44, GJEDNJ 2009 ... (ekstrakte)).

107. Për sa i përket respektimit të jetës private, Gjykata është shprehur më parë, në kontekste të ndryshme, se koncepti i jetës private përfshin integritetin fizik dhe psikologjik të një personi. Sipas nenit 8, Shtetet kanë për detyrë të mbrojnë integritetin fizik dhe moral të një personi nga persona të tjerë. Për këtë qëllim, ato duhet të ruajnë



dhe të zbatojnë në praktikë një kuadër ligjor të duhur që ofron mbrojtje kundër akteve të dhunës nga persona privatë (shihni *X dhe Y*, cituar më lart, §§ 22 dhe 23; *Costello-Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 25 mars 1993, § 36, seria A, nr. 247-C; *D.P. dhe J.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 38719/97, § 118, 10 tetor 2002; *M. C. kundër Bullgarisë*, nr. 39272/98, §§ 150 dhe 152, GJEDNJ 2003 XII; *Beracqua dhe S. kundër Bullgarisë*, nr. 71127/01, § 65, 12 qershor 2008; dhe *Sandra Janković*, cituar më lart, § 45).’’.

59. Në kuadrin e ofrimit të një shërbimi të rëndësishëm publik siç është arsimi, roli thelbësor i autoriteteve arsimore është të mbrojnë shëndetin dhe mirëqenien e studentëve, duke pasur parasysh, veçanërisht, cenueshmërinë e tyre për shkak të moshës së tyre të re. Kështu, detyra parësore e autoriteteve arsimore është të garantojnë sigurinë e studentëve për t’i mbrojtur ata nga çdo formë dhune gjatë kohës që ata janë nën mbikëqyrjen e autoriteteve arsimore (shihni *F. O. kundër Kroacisë*, nr. 29555/13, § 82, 22 prill 2021, me referenca të mëtejshme).

60. Për sa i përket disiplinës shkollore, Gjykata është shprehur se ajo përfshihet në fushën e së drejtës për arsim dhe se shteti nuk mund të zhvishet nga përgjegjësia, duke deleguar detyrimet e tij tek organet ose personat privatë (shihni *Costello-Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 25 mars 1993, §§ 27 dhe 28, seria A, nr. 247 C, në lidhje me sjelljen e mësuesve). Gjykata vlerëson se e njëjta gjë vlen edhe për sa i përket çështjeve të disiplinës shkollore në marrëdhëniet ndërmjet nxënësve (shihni *Durdević*, cituar më lart, § 104).

b) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

61. Palët bënë parashtrime të ndryshme për rrethanat në të cilat ndodhi ngjarja. Ndërsa kërkuesi u shpreh se autoritetet e shkollës e dinin që katapultat kishin qarkulluar nëpër klasa, sepse një nga nxënësit kishte sjellë rreth njëzet prej tyre në shkollë dhe i kishte shpërndarë mes nxënësve, Qeveria u shpreh që nxënësi që kishte plagosur djalin e kërkuetit kishte përdorur shirita llastiku, të cilat nxënësit i përdornin për të lidhur kartëmonedhat. Kërkuesi pretendoi, gjithashtu, se autoritetet e shkollës nuk kishin marrë hapat e duhur për të parandaluar incidente si ai në fjalë.

62. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se, si çështje parimore, ajo nuk mund të zëvendësojë gjetjet e fakteve të autoriteteve kombëtare me të sajat. Roli i

saj është mbikëqyrës, kështu, ajo vlerëson nëse përgjigja e autoriteteve kombëtare ndaj ankimit të një kërkueti është në përputhje me detyrimet e shtetit sipas Konventës.

63. Për sa i përket përgjigjes së kërkuar nga autoritetet e brendshme për situatën në fjalë, Gjykata thekson se një sulm ndaj integritetit fizik të një personi në parim do të kërkonte një përgjigje ligjore, gjithashtu, në çështjet në lidhje me nenin 8 të Konventës (shihni, për shembull, *Remetin kundër Kroacisë*, nr. 29525/10, § 76, 11 dhjetor 2012; *Remetin kundër Kroacisë (nr. 2)*, nr. 7446/12, § 70, 24 korrik 2014; dhe *Isaković Vidović kundër Serbisë*, nr. 41694/07, § 47, 1 korrik 2014). Megjithatë, në lidhje me aktet më pak të rënda ndërmjet individëve, të cilat mund të cenojnë integritetin psikologjik, detyrimi i shtetit sipas nenit 8 për të ruajtur dhe zbatuar në praktikë një kuadër ligjor të duhur që ofron mbrojtje nuk kërkon gjithmonë që të jetë në fuqi një dispozitë efikase e ligjit penal që mbulon aktin specifik. Kuadri ligjor mund të përbëhet, gjithashtu, nga mjete juridike civile të cilat mund të ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme (shihni *Söderman kundër Suedisë* [DHM], nr. 5786/08, § 85, GJEDNJ 2013, shihni, gjithashtu, *Špadijer kundër Malit të Zi*, nr. 31549/18, § 89, 9 nëntor 2021).

64. Ndërsa në çështjen në fjalë, sulmi ndaj djalit të kërkuetit përfshinte dhunë fizike, Gjykata vëren se autori i aktit të supozuar ishte i mitur që nuk i kishte mbushur ende katërmbëdhjetë vjeç dhe për rrjedhojë ishte nën moshën e përgjegjësisë penale. Në fakt, kërkuesi nuk u ankua se autoritetet nuk kishin përmblusur detyrimin e tyre pozitiv për të filluar ndjekje penale efektive në mënyrë që të siguronin mbrojtjen e duhur të të drejtave të djalit të tij, sipas nenit 8 të Konventës. Më konkretisht, kërkuesi pretendoi që gjykatat vendase nuk i kishin përmblusur detyrimet e tyre pozitive, për shkak se nuk i kishin dhënë atij dëmshpërblim. Rrjedhimisht, kërkuesi nuk pretendoi që përdorimi i ligjit penal ishte e vetmja mënyrë që shteti i paditur të mund të përmblushte detyrimin e tij, sipas nenit 8, për të mbrojtur djalin e tij nga dhuna në shkollë (krahasoni *Söderman*, cituar më lart, §§ 87 dhe 88).

65. Prandaj, Gjykata është e bindur se në këtë çështje, që përfshin një sulm nga një nxënës nën moshën katërmbëdhjetë vjeç ndaj një nxënësi tjetër, duke përdorur një katapultë, në rrethana kur nuk ka pasur asnjë akt dhune ose mosveprim të qëllimshëm për të vepruar nga ana e ndonjë anëtarit të stafit të



shkollës, jo domosdoshmërisht kërkohet një hetim penal (shihni, *mutatis mutandis*, F. O. kundër Kroacisë, cituar më lart, § 93).

66. Gjykata thekson se detyra e saj nuk është të zëvendësojë autoritetet e brendshme kompetente në përcaktimin e metodave më të përshtatshme për mbrojtjen e individëve nga sulmet ndaj integritetit të tyre personal, por më tepër të vlerësive, sipas Konventës, vendimet që ato autoritete kanë marrë gjatë ushtrimit të diskrecionit të tyre. Prandaj, Gjykata do të shqyrtojë nëse shteti i paditur, në trajtimin e çështjes së kërkuarit ka shkelur detyrimet e tij pozitive, sipas nenit 8 të Konventës (shihni *Sandra Janković*, § 46, dhe *Isaković Vidović*, § 60, të dy të cituar më lart).

67. Lidhur me mbrojtjen e integritetit fizik dhe psikologjik të një personi nga persona të tjerë, Gjykata ka vendosur më parë se detyrimet pozitive të autoriteteve – në disa çështje sipas neneve 2 ose 3 të Konventës dhe në çështje të tjera sipas nenit 8, të marra vetëm ose në kombinim me nenin 3 – mund të përfshijnë detyrimin për të ruajtur dhe zbatuar në praktikë një kuadër ligjor të duhur që ofron mbrojtje kundër akteve të dhunës nga persona privatë (shihni *Söderman*, cituar më lart, § 80, me referenca të mëtejshme). Në kontekstin e dhunës në shkollë, Gjykata thekson se, në përputhje me parimet e mësipërme, sipas nenit 8 që kërkon mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë dhune ose abuzimi në institucionet arsimore (shihni paragrafët 58–60 më lart), dhe me standardet përkatëse ndërkombëtare (shihni paragrafin 28 më lart), autoritetet e brendshme duhet të vendosin masat e duhura legislative, administrative, sociale dhe edukative për të ndaluar pa mëdyshje çdo sjellje të tillë kundër fëmijëve, në çdo kohë dhe në çdo rrethanë, dhe, në këtë mënyrë, të sigurojnë zero tolerancë ndaj çdo forme dhune ose abuzimi në institucionet arsimore. Kjo lidhet edhe me domosdoshmërinë e sigurimit të llogaridhënies përmes rrugëve të përshtatshme penale, civile, administrative dhe profesionale. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se shteti gëzon diskrecion në përcaktimin e mënyrës se si do të organizojë sistemin e tij për të siguruar pajtueshmërinë me Konventën (shihni F. O., cituar më lart, § 91).

68. Për sa i përket kuadrit ligjor shqiptar në kohën përkatëse, Gjykata vëren se neni 66, i ligjit nr. 7952, për institucionet arsimore, parashikon se shteti duhet të garantojë sigurinë e mësuesve dhe

nxënësve, si edhe sigurinë e institucioneve arsimore dhe mjediseve të tyre (shihni paragrafin 25 më sipër). Për më tepër, funksionimi i shkollave private, duke përfshirë sigurinë në këto shkolla, i është besuar në përgjithësi Ministrisë së Arsimit. Detyrat e inspektimit të Inspektoratit Shtetëror, nën mbikëqyrjen e ministrit të Arsimit, përfshijnë verifikimin e përshtatshmërisë dhe respektimit në praktikë të masave të sigurisë, planeve dhe rregullave të brendshme për parandalimin e dëmtimeve dhe sigurinë e nxënësve. Sipas nenit 25, të ligjit 10433, një inspektim i rastësishëm mund të kryhet, *inter alia*, kur një aksident ose një incident ka ndikuar ose rrezikon të ndikojë në jetën ose shëndetin e njerëzve (shihni paragrafin 27 më lart).

69. Megjithatë, Gjykata vëren se kërkuari nuk kërkoi që të ndërmerrej ndonjë masë administrative ose hetim zyrtar (krahasoni F. O., cituar më sipër, § 12).

70. Për sa i përket mekanizmave të së drejtës civile në Shqipëri, Gjykata vëren se neni 608 i Kodit Civil parashikon detyrimin për të kompensuar dëmin fizik ose psikologjik të shkaktuar ndaj një personi tjetër. Neni 614 dhe neni 615 i bëjnë prindërit dhe kujdestarët, përfshirë mësuesit përgjegjës për të miturit, përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga të miturit dhe personat me një paaftësi, me përjashtim të rastit kur vërtetojnë se nuk kanë mundur të parandalojnë lëndimin ose dëmin. Lloji i dëmit për të cilin duhet të jepet kompensimi është përcaktuar në nenin 640 dhe nenin 641, dhe përfshin dëmin ndaj shëndetit dhe shpenzimet përkatëse (shihni paragrafin 18 më lart).

71. Kërkuari ngriti padi civile kundër shkollës, duke kërkuar kompensim për dëmin që djali i tij kishte pësuar kur u godit nga një nxënës tjetër i asaj shkolle. Autoritetet kombëtare konstatuan se shkolla nuk ishte përgjegjëse sepse, *inter alia*, incidenti kishte ndodhur gjatë një pushimi mes orëve kur autoritetet e shkollës, sipas mendimit të tyre, nuk kishin qenë në gjendje të mbikëqyrnin nxënësit (shih paragrafin 9 më lart). Megjithatë, Gjykata nuk mund të pajtohet me këtë vlerësim. Ajo ka vendosur tashmë se një institucion arsimor është në parim i detyruar të mbikëqyrë nxënësit gjatë të gjithë kohës që ata kalojnë nën kujdesin e tij (shihni *Kayak kundër Turqisë*, nr. 60444/08, § 60, 10 korrik 2012).

72. Në çështjen në fjalë, nuk kontestohet fakti që ngjarja në fjalë ka ndodhur në ambientet e shkollës



gjatë orarit të rregullt të shkollës dhe që autori, i cili ka kryer veprime me rrezikshmëri të lartë, ka qenë nxënës i asaj shkolle. Pritet që institucionet arsimore të marrin masat e duhura për të parandaluar përdorimin e objekteve të rrezikshme nga nxënësit në ambientet e shkollës ose në mbikëqyrje. Gjuajtja e një objekti të fortë me shirit llastiku ndaj një nxënësi tjetër është potencialisht e rrezikshme dhe mund të çojë në dëmtime serioze, siç ndodhi në këtë rast.

73. Edhe pse nuk mund të pritet që stafi mësimor të sigurojë mbikëqyrje të vazhdueshme të çdo nxënësi në mënyrë që t'i përgjigjet menjëherë çdo sjelljeje të paparashikueshme, autoritetet e shkollës janë përgjegjëse për disiplinën e shkollës, sidomos mes nxënësve të saj, në çdo kohë kur nxënësit janë në shkollë, apo edhe jashtë saj, por nën mbikëqyrjen e shkollës (krahasoni *Kayak*, cituar më lart, § 60). Përndryshe, mbrojtja e të miturve gjatë orarit të mësimi nuk do të garantohej, pasi asnjë autoritet nuk do të mbante përgjegjësi për sigurinë e tyre gjatë pushimeve. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se gjykatat kombëtare konstatuan se shiritat e llastikut, si ato me të cilat u qëllua një objekt ndaj djalit të kërkuarit, ishin përdorur për lidhjen e kartëmonedhave, por shkolla nuk arriti të shpjegonte pse nxënësit njëmbëdhjetëvjeçarë kanë nevojë për llastikë që të mbajnë të lidhura para xhepi. Kërkuari pretendoi se një nxënës tjetër kishte sjellë njëzet llastiqe në shkollë dhe i kishte shpërndarë mes nxënësve, të cilët i kishin përdorur haptazi në ditët para incidentit. Këto pretendime të kërkuarit nuk u vunë në shqyrtim ose nuk u trajtuan në mënyrën e duhur nga gjykatat e brendshme në vendimet e tyre të arsyetuara.

74. Sa i përket masave që shkolla mori pas incidentit, gjykatat e brendshme konstatuan që ajo kishte mbledhur donacione nga prindërit e nxënësve të tjerë dhe kishte kontaktuar kompaninë e saj të sigurimit, duke i kërkuar të paguante shpenzimet e trajtimit mjekësor të djalit të kërkuarit (shihni paragrafët 7 dhe 9 më lart). Megjithatë, pretendimet faktike të ngritura nga kërkuari nuk u adresuan, domethënë që ai nuk ishte informuar menjëherë për incidentin dhe autoritetet e shkollës nuk kishin reaguar menjëherë për të siguruar që djali i tij të merrte trajtim mjekësor urgjent. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësimin e vet për këto pretendime; gjykatat e brendshme duhet t'i kishin shqyrtuar siç duhej në vendimet e tyre të arsyetuara.

75. Gjykata vëren, gjithashtu, se gjykatat e brendshme konstatuan se shkolla kishte bërë marrëveshje sigurimi me një kompani sigurimesh që mbulonte të gjithë nxënësit e saj dhe se, për rrjedhojë, kërkuari duhej të kishte kërkuar kompensim nga ajo kompani sigurimi (shihni paragrafët 7 dhe 9 më lart). Megjithatë, Gjykata vëren se ishte shkolla dhe jo kërkuari që kishte lidhur marrëveshjen me kompaninë e sigurimit. Kërkuari kishte të drejtën, e njohur sipas ligjit të brendshëm, që të kërkonte dëmshpërblim nga shkolla. Nëse do të kishte marrë dëmshpërblimin, shkolla mund të kishte kërkuar rimbursimin nga shoqëria e sigurimit, nëse do të ishin plotësuar kërkesat ligjore për rimbursim. Prandaj, është e vështirë të merret në konsideratë që në vlerësimin e tyre të përgjithshëm, autoritetet kombëtare morën parasysh si duhet parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

76. Në këto rrethana, Gjykata nuk është e bindur që proceset civile të zhvilluara në këtë çështje ofrojnë mbrojtje të duhur për situatën në fjalë, veçanërisht, duke pasur parasysh parimin që fëmijët dhe personat e tjerë të cënueshëm kanë të drejtë për mbrojtje efektive nga autoritetet (shihni, për shembull, *O'Keeffe kundër Irlandës* [DHM], nr. 35810/09, § 44, KEDNJ 2014 (ekstrakte)), një parim i njohur edhe në nenin 54 të Kushtetutës së Shqipërisë.

77. Duke marrë parasysh konsideratat e mësipërme, Gjykata konstaton se mjeti juridik civil, në dispozicion të kërkuarit në rrethanat e çështjes në fjalë, nuk i ofroi mbrojtje të duhur djalit të kërkuarit nga sulmi ndaj integritetit të tij fizik dhe se mënyra se si u zbatuan në këtë rast mekanizmat ligjorë ishin të mangëta, aq sa përbënin shkelje të detyrimeve të shtetit të paditur, sipas nenit 8 të Konventës, veçanërisht, duke pasur parasysh rëndësinë kryesore të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

78. Kërkuari u ankua për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë dhe për shkeljen e të drejtës së tij për akses në gjykatë, për shkak të llogaritjes së afatit kohor brenda të cilit ai duhej të paraqiste ankimin përpara Gjykatës Kushtetuese. Ai u mbështet në nenin 6 § 1 të Konventës, pjesa përkatëse e së cilës lexon si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile çdo person ka të drejtë që çështja e tij të



dëgjohet brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë”.

A. Pranueshmëria

1. Kohëzgjatja e procesit gjyqësor

79. Qeveria parashtroi se ligji nr. 38/2017, i 30 marsit 2017, i cili kishte ndryshuar Kodin e Procedurës Civile, kishte prezantuar një mjet të ri juridik për proceset civile tepër të zvarritura, duke mundësuar përshpejtimin e tyre dhe/ose kërkimin e dëmshpërblimit në rast të konstatimit të tejkalimit të kohëzgjatjes. Kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet e brendshme juridike sepse ai nuk e kishte përdorur atë mjet.

80. Në veçanti, për sa i përket kohëzgjatjes së proceseve në Gjykatën e Lartë, Qeveria parashtroi se në vitin 2021 ishin bërë një sërë ndryshimesh në Kodin e Procedurës Civile me synimin specifik të rritjes së efektivitetit të shqyrtimit të çështjeve në pritje në Gjykatën e Lartë. Në atë kohë, Gjykata e Lartë kishte nëntë gjyqtarë, tre në secilin kolegji të saj (administrativ, civil dhe penal). Një shqyrtim paraprak i çdo çështjeje u krye nga një gjyqtar i vetëm. Efikasiteti i shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë ishte rritur me 46% nga viti 2020 në 2021.

81. Kërkuesi nuk bëri asnjë koment në lidhje me këtë.

82. Gjykata vëren se mjetet e reja juridike për kohëzgjatjen e proceseve u miratuan më 30 mars 2017 dhe hynë në fuqi më 5 nëntor 2017. Këto mjete juridike, në parim, duhet të shterohen përpara se të paraqitet një ankim në Gjykatë për kohëzgjatjen e proceseve (shihni *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 dhe 17766/19, § 119, 12 tetor 2021). Më tej, pas ndryshimeve të datës 12 gusht 2016, në lidhje me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, në parim, ankimi kushtetues u bë një mjet efektiv për t'u ezauruar për të gjitha ankimet sipas Konventës (shihni *Fullani kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 4586/18, § 79, 20 shtator 2022).

83. Prandaj, kërkuesi mund të kishte kërkuar, pas datës 5 nëntor 2017, një vendim për tejkalimin e kohëzgjatjes së procesit nga një trup gjykues tjetër i Gjykatës së Lartë, sipas nenit 399/6 (1) (c), të Kodit të Procedurës Civile, ose të kishte ngritur një pretendim të tillë në ankimin e tij kushtetues, të depozituar më 8 shkurt 2018. Nëse do ta kishte bërë këtë dhe nëse Gjykata e Lartë ose Gjykata Kushtetuese do të kishte konstatuar shkelje të së drejtës së kërkuesit për gjykim të shpejtë, ai do të

kishte pasur mundësinë, sipas ligjit nr. 38/2017, datë 30 mars 2017, për të kërkuar dëmshpërblim pranë një gjykate rrethi.

84. Në këto rrethana, ky ankim duhet të refuzohet sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4, të Konventës për mosshkrimin e mjeteve të brendshme ligjore.

2. Aksesit në Gjykatën Kushtetuese

85. Gjykata vëren se ky ankim nuk është as haptazi i pabazuar dhe as i papranueshëm për ndonjë nga shkaqet e tjera të renditura në nenin 35 të Konventës. Prandaj, ai duhet të shpallet i pranueshëm.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

86. Kërkuesi argumentoi në kërkesën e tij se i ishte shkelur e drejta e aksesit në Gjykatën Kushtetuese për shkak se afati katërmujor për të bërë ankim kushtetues ishte llogaritur nga data në të cilën ishte dhënë vendimi i Gjykatës së Lartë dhe jo nga data kur i ishte njoftuar atij.

87. Qeveria pohoi se ka qenë praktikë e Gjykatës Kushtetuese që të llogarisë afatin kohor prej katër muajsh për paraqitjen e ankimit kushtetues nga data e dhënies së vendimit të kontestuar.

Ata ishin të mendimit se aksesit në Gjykatën Kushtetuese, në mënyrë të arsyeshme, mund t'i nënshtrohej rregullave më të rrepta se ato që zbatoheshin për gjykatat e zakonshme. Kërkuesi mund të kishte marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë nga faja e internetit e asaj gjykate.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parime të përgjithshme

88. Parimet përkatëse mbi të drejtën e aksesit në gjykatë dhe, në veçanti, për aksesin në gjykatat e larta janë përmbledhur në *Zubac kundër Kroacisë* ([DHM], nr. 40160/12, §§ 76–99, 5 prill 2018) dhe *Supergrav Albania sh.p.k. kundër Shqipërisë* (nr. 20702/18, § 16, 9 maj 2023).

b) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

89. Për sa i përket çështjes në fjalë, Gjykata vëren se kërkuesi depozitoi një ankim kushtetues kundër vendimit të Gjykatës së Lartë, të datës 26 shtator 2017, pra pas datës 1 mars 2017, kur ka hyrë në fuqi afati katërmujor për paraqitjen e ankimit kushtetues. Prandaj, afati i ri kohor prej katër muajsh zbatohet qartë për çështjen e kërkuesit.

90. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë dha një vendim për ankimin e ankuesit më 26 shtator 2017, e mbledhur me dyer të mbyllura, pa praninë e



kërkuesit ose avokatit të tij (shihni paragrafin 11 më lart). Prandaj, kërkuesi nuk kishte dijeni për këtë. Vendimi i Gjykatës së Lartë iu dorëzua kërkuesit më 10 janar 2018 (shihni paragrafin 12 më lart), kur kërkuesi pati mundësinë e parë për të lexuar arsyetimin e plotë të Gjykatës së Lartë për vendimin e saj.

91. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se afati prej katër muajsh për paraqitjen e ankimit kushtetues duhej të llogaritej nga data 10 janar 2018, kur kërkuesit i ishte dorëzuar vendimi i Gjykatës së Lartë. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese llogariti afatin nga data 26 shtator 2017, kur Gjykata e Lartë kishte dhënë vendimin e saj.

92. Gjykata ka konstatuar më parë shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, ku afati katërmujor për paraqitjen e ankimit kushtetues ishte llogaritur nga data e dhënies së vendimit të kontestuar të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data kur i ishte dorëzuar kërkuesit (shihni *Supergrav Albania Shpk*, cituar më sipër, §§ 17–31). Ajo nuk sheh asnjë arsye për të devijuar nga ky përfundim në çështjen në fjalë.

93. Në këto rrethana, konstatohet, gjithashtu, shkelje e nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me të drejtën e kërkuesit për akses në Gjykatën Kushtetuese.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

94. Neni 41 i Konventës lexon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar”.

A. Dëmi

95. Kërkuesi kërkoi 2,289,727 lekë për dëmin, nga të cilat 60% për dëmin pasuror dhe 40% për dëmin jopasuror për shkak të vuajtjes së djalit të tij.

96. Qeveria e kundërshtoi këtë pretendim.

97. Neni 41 e fuqizon Gjykatën që t'i japë palës së dëmtuar atë shpërblim që i duket i përshtatshëm (shihni *O'Keefe kundër Irlandës* [DHM], nr. 35810/09, § 199, ECHR 2014). Gjykata vëren se kërkuesi nuk e specifikoi pretendimin e tij për dëmin pasuror, i cili për rrjedhojë duhet të refuzohet. Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se djali i kërkuesit, në emër të të cilit u depozitua kërkesa, duhet të ketë pasur ankth dhe shqetësim për shkak të fakteve që kanë shkaktuar konstatimin e shkeljes në çështjen në fjalë. Gjykata, duke vendosur mbi baza të barabarta,

cakton për kërkuesin shumën 11,700 euro në lidhje me dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund të ngarkohet.

B. Kosto dhe shpenzime

98. Gjithashtu, kërkuesi pretendoi 763,142 euro për kosto dhe shpenzime të bëra para gjykatave të brendshme.

99. Qeveria e kundërshtoi këtë pretendim.

100. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, një kërkues ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve vetëm për atë që provohet se ato janë bërë realisht dhe domosdoshmërisht, dhe janë të arsyeshme sa i përket shumës. Në këtë çështje, Gjykata vëren se kërkuesi ndoqi proceset përpara katër shkallëve të gjykatave të brendshme përpara se të paraqiste kërkesën e tij në Gjykatë.

101. Duke pasur parasysh dokumentet përpara saj dhe kriteret e mësipërme, Gjykata e vlerëson të arsyeshme që t'i caktojë kërkuesit shumën prej 5.000 EUR për të mbuluar shpenzimet për proceset e brendshme gjyqësore, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA,

1. *vendos* njëzëri që kërkuesi legjitimohet për të paraqitur kërkesën në emër të djalit të tij;

2. *shpall*, njëzëri, të pranueshme ankimet sipas nenit 8 dhe në lidhje me të drejtën e tij për akses në Gjykatën Kushtetuese sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës dhe të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

3. *vendos* me katër vota pro dhe tre kundër që ka gjetur shkelje të nenit 8 të Konventës;

4. *vendos*, njëzëri, që është shkelur paragrafi 1, i nenit 6 të Konventës, për mungesën e aksesit të kërkuesit në Gjykatën Kushtetuese;

5. *vendos*, me katër vota pro dhe tre kundër,

a) që shteti i paditur t'i paguajë kërkuesit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në përputhje me paragrafin 2, të nenit 44 të Konventës, shumat e mëposhtme që do të konvertohen në monedhën e shtetit të paditur, me kursin e këmbimit në fuqi në datën e shlyerjes:

i. 11.700 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind euro) EUR për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet;

ii. 5.000 (pesë mijë euro) EUR për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuesit;

b) nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, interes i thjeshtë të



paguhet për shumat e mësipërme sipas normës së njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje;

6. *rrezon*, njëzëri, pjesën tjetër të pretendimit të kërkuarit për shpërblim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 4 maj 2024, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Milan Blaško
KANCELAR

Në përputhje me nenin 45 § 2 të Konventës dhe rregullin 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës, këtij vendimi i bashkëngjiten mendimet e veçanta të mëposhtme:

- Mendim paralel i gjyqtarit Serghides;
- Mendim pakice, pjesërisht i përbashkët, i gjyqtarëve Pastor Vilanova, Schukking and Roosma.

PPV
MIB

MENDIMI PARALEL I GJYQTARIT SERGHIDES

1. Hyrje

1. Kërkuar u ankua sepse shteti i paditur nuk kishte përmbushur detyrimin e tij, në lidhje me një sulm ndaj djalit të tij njëmbëdhjetëvjeçar nga një shok klase trembëdhjetë vjeç, duke përdorur një katapultë në shkollën private (të licencuar nga shteti) që ata të dy frekuentonin; goditja shkaktoi dëmtim të rëndë në syrin e djalit të tij. Më tej, ankimi ka të bëjë me kohëzgjatjen e proceseve civile për dëmshpërblim në këtë drejtim dhe të drejtën e ankuesit për akses në Gjykatën Kushtetuese, të dyja objekt i ankimit të kërkuarit sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës.

2. Si një nga katër gjyqtarët në shumicë, unë votova pro për gjashtë pikat e dispozitivit të vendimit.

3. Qëllimi i këtij mendimi paralel është që të shtjellojë qëndrimin tim, në lidhje me dështimin e shtetit të paditur për të përmbushur detyrimin e tij pozitiv, sipas nenit 8. Kështu ky opinion kufizohet vetëm për vendimin e Gjykatës në pikën 3 të dispozitivit.

2. Rëndësia dhe evolucioni i doktrinë së detyrimeve pozitive

4. Siç theksoi Starmer: “në shumë aspekte detyrimet pozitive janë shenja dalluese e GJEDN]-së”¹ ~~Pastor Vilanova~~ Stoyanova: “[z]hvillimi i detyrimeve pozitive ka qenë një nga shenjat dalluese të punës së Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut... në interpretimin [dhe do të shtoja gjithashtu në zbatimin] e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”². Detyrimet pozitive të shteteve janë po aq të rëndësishme sa detyrimet e tyre negative, në lidhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Marrëdhënia ndërmjet detyrimeve pozitive dhe parimit të efektivitetit mund të thuhet se i ngjan marrëdhënies mes pasardhësve dhe paraardhësve të tyre³.

5. Doktrina e detyrimeve pozitive, siç u bë e njohur përfundimisht, siguron që mbrojtja e të drejtave të njeriut të jetë e plotë dhe gjithëpërfshirëse; kështu, duke shkuar përtej detyrimeve të tyre negative, edhe shtetet kanë dhe duhet të përmbushin detyrimet pozitive. Koncepti i detyrimeve pozitive u shfaq për herë të parë në jurisprudencën e Gjykatës në vitin 1968 në çështjen *Belgian Linguistic*,⁴ ku Gjykata u shpreh se, pavarësisht formulimit negativ të nenit 2, të Protokollit të Parë të Konventës (mbi të drejtën për arsim), shtetet akoma kishin një detyrim pozitiv për t’u siguruar që kjo e drejtë të realizohej⁵. Që nga ai vendim i hershëm, doktrina e detyrimeve pozitive është zhvilluar dhe zgjeruar vazhdimisht nga Gjykata. Kjo ishte, gjithashtu, çështja e parë ku Gjykata iu referua dhe zbatoi parimin e efektivitetit në formulimin e saj të drejtpërdrejtë. Njohja dhe zhvillimi i detyrimeve pozitive nga praktika gjyqësore mund të shihet, gjithashtu, si një aspekt i rëndësishëm i Konventës, duke u zhvilluar për shkak të natyrës së saj të

¹ Shihni Keir Starmer, “Positive Obligations under the Convention” në J. Jowell dhe J. Cooper (eds), *Understanding Human Rights Principles*, Oxford-Portland-Oregon, 2001, f. 159.

² Shihni Vladislava Stoyanova, *Positive Obligations Under the European Convention on Human Rights – Within and Beyond Boundaries*, Oxford University Press, 2023, f. 1.

³ Një ngjashmëri që unë e përmenda edhe në paragrafin 7 të mendimit tim paralel në *Güzelyurtlu dhe të tjerët kundër Qipros dhe Turqisë* [DHM], 36925/07, 29 janar 2019.

⁴ Çështje në lidhje me disa aspekte të së drejtës për përdorimin e gjuhëve në arsim në Belgjikë kundër Belgjikës (*Themeli*), nr. 1474/62, 23 korrik 1968.

⁵ Shihni çështjen *Belgian Linguistic* cituar më lart, në f. 27.



qenësishme si një instrument i gjallë. Kjo tregon ndërlidhjen mes doktrinë së detyrimeve pozitive dhe doktrinë se Konventa është një instrument i gjallë për t'u interpretuar, duke pasur parasysh kushtet e sotme. Është interesant fakt që doktrina e fundit u shpall për herë të parë nga Gjykata dhjetë vjet pas të parës, përkatësisht, në vitin 1978, dhe më konkretisht në vendimin e saj në *Tyrer kundër Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 5856/72, 25 prill 1978).

6. Siç e kam argumentuar edhe diku tjetër⁶, doktrina e detyrimeve pozitive dhe doktrina e instrumentit të gjallë plotësojnë njëra-tjetrën; ato ndajnë të njëjtin ose një paraardhës të përbashkët, domethënë, parimin e efektivitetit, dhe ato punojnë së bashku për të siguruar respektimin e atij parimi. Të dyja këto doktrina i konsideroj si nënnorma dhe nënmetoda të parimit të efektivitetit në kapacitetet e tij përkatëse si normë e së drejtës ndërkombëtare dhe si metodë interpretimi.

3. Arsyet pse detyrimet pozitive të shtetit të paditur mund të konsiderohen të papërbushura

7. Më lejoni të filloj duke thënë se një kuadër ligjor ishte i domosdoshëm në çështjen në fjalë për mbrojtjen e djalit të kërkuesit gjatë qëndrimit në shkollë dhe për përbushjen nga shteti të detyrimeve të tij pozitive sipas nenit 8. Për ta vendosur parashtrimin tim në një kontekst më të përgjithshëm, nevojiten korniza ligjore në të gjitha fushat e jetës ku kërkohet mbrojtja e të drejtave të njeriut, veçanërisht, në rastet kur bëhet fjalë për persona të cënueshëm, si të miturit dhe të burgosurit. Për mendimin tim, një detyrë e tillë për të krijuar kuadrin ligjor nga Palët e Larta Kontraktuese nënkuptohet në detyrimin e tyre sipas nenit 1 të Konventës që t'i "sigurojnë çdokujt brenda juridiksionit të tyre, të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Seksionin I, të kësaj Konvente". Është në kompetencën e Gjykatës të sigurojë respektimin e këtij detyrimi, sipas nenit 19 të Konventës, si edhe sipas parimit të efektivitetit, që është thelbësor në Konventë. Për më tepër, për nevojën e krijimit të kornizave ligjore në çështje si kjo, vendimi në paragrafin 67 me të drejtë thekson sa vijon:

"Lidhur me mbrojtjen e integritetit fizik dhe psikologjik të një personi nga persona të tjerë, Gjykata ka vendosur më parë se detyrimet pozitive të autoriteteve – në disa çështje sipas neneve 2 ose 3 të Konventës dhe në çështje të tjera sipas nenit 8, të marra vetëm ose në kombinim me nenin 3 – mund të përfshijnë detyrimin për të ruajtur dhe zbatuar në praktikë një kuadër ligjor të duhur që ofron mbrojtje kundër akteve të dhunës nga individë privatë (shihni *Söderman*, cituar më lart, § 80, me referenca të mëtejshme). Në kontekstin e dhunës në shkollë, Gjykata thekson se në përputhje me parimet e mësipërme sipas nenit 8 që kërkon mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë dhune ose abuzimi në institucionet arsimore (shihni paragrafët 58–60 më lart), dhe me standardet përkatëse ndërkombëtare (shihni paragrafin 28 më lart), autoritetet e brendshme duhet të vendosin masat e duhura legjislative, administrative, sociale dhe edukative për të ndaluar pa mëdyshje çdo sjellje të tillë kundër fëmijëve në çdo kohë dhe në çdo rrethanë, dhe në këtë mënyrë të sigurojnë zero tolerancë ndaj çdo forme dhune ose abuzimi në institucionet arsimore. Kjo lidhet edhe me domosdoshmërinë e sigurimit të llogaridhënies përmes rrugëve të përshtatshme penale, civile, administrative dhe profesionale."

Prandaj pyetja përkatëse që shtrohet është si vijon: A ekzistonte një kuadër i tillë ligjor në kohën në fjalë? Autoritetet kombëtare, duke vendosur në bazë të nenit 615 të Kodit Civil Shqiptar (cituar në paragrafin 18 të vendimit), që shkolla nuk ishte përgjegjëse për shkak se incidenti kishte ndodhur gjatë një pushimi mes orëve, në fakt pranuan se nuk kishte asnjë kuadër ligjor përkatës dhe, për rrjedhojë, se ato nuk kanë përbushur detyrimet e tyre pozitive sipas nenit 8.

Megjithatë, vendimi, dhe me të drejtë, nuk pajtohet me vlerësimin e autoriteteve kombëtare në lidhje me përgjegjësinë e shkollës, *inter alia*, sepse, siç u vendos në çështjen *Kayak kundër Turqisë* (nr. 60444/08, § 60, 10 korrik 2012), një institucion arsimor në parim është i detyruar të mbikëqyrë nxënësit gjatë të gjithë kohës që ata kalojnë nën kujdesin e tij (shihni paragrafët 71–73 të vendimit). Përveç asaj që është arsyetuar në vendim, unë arsyetoj sa më poshtë. Interpretimi dhe zbatimi nga

⁶ Shihni G. A. Serghides, "The Principle of Effectiveness and the European Convention on Human Rights", në D. D'Abra, P. Ducoulombier, G. Eckert, J. P. Jacqué and P.

Wachsmann (eds), *Mélanges en L'Honneur de Florence Benoit-Rohmer - Les droits de l'homme, du Conseil de l'Europe à l'Union européenne*, Bruylant, 2023, 535, f. 545–546.



autoritetet kombëtare i fjalëve “që kanë nën mbikëqyrje” në nenin 615 të Kodit Civil Shqiptar, i cili kufizon përgjegjësinë e mësuesve dhe personave të tjerë përgjegjës për të miturit, duke përfshirë vetëm kohën kur nxënësit janë në klasë dhe jo në këndin e lojërave, ishte tepër kufizues, arbitrar dhe nuk ishte në përputhje me Konventën. Nuk ishte në përputhje me parimin e efektivitetit. Për më tepër, ky interpretim nuk ishte në përputhje me qëllimin e nenit 66, të ligjit nr. 7952, i cili parashikon se shteti duhet të garantojë sigurinë e mësuesve dhe nxënësve, si dhe sigurinë e institucioneve arsimore dhe mjediseve të tyre (shihni paragrafët 25 dhe 68 të vendimit). Neni 615 duhet të interpretohet dhe të zbatohet për të përfshirë përgjegjësinë e mësuesve dhe personave të tjerë përgjegjës në shkollë, si edhe përgjegjësinë e shtetit për çdo dëm të shkaktuar ndaj të miturve gjatë kohës që ata janë në shkollë, pavarësisht nëse janë në klasë apo në këndin e lojërave gjatë pushimit të tyre. Me fjalë të tjera, për sa kohë që fëmijët nuk janë me prindërit ose kujdestarët e tyre dhe janë në shkollë, shkollë dhe shteti duhet të mbajë përgjegjësi për çdo dëmtrim që mund të pësojnë nga fëmijët e tjerë. Të shprehësh të kundërtën do të çonte në përfundimin absurd se fëmijët gjatë pushimeve në shkollë nuk janë nën kujdesin e askujt.

Duhet të theksohet se detyrimi i shteteve për të përmbushur detyrimet e tyre pozitive është edhe më i madh për njerëzit vulnerabël, si fëmijët kur janë në shkollë. Për më tepër, neni 615 i Kodit Civil Shqiptar duhet të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë që të jetë në përputhje me dispozitat përkatëse të Konventës, përkatësisht nenet 3 dhe 8, të cilat, nga ana tjetër, duhet të interpretohen dhe të zbatohen në harmoni me nenet 3 dhe 19, të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (cituar në paragrafin 28 të vendimit). Këtë e kërkon parimi i koherencës së jashtme, që është një aspekt apo dimension i parimit të efektivitetit.

Më tej, Qeveria arsyetoi se kërkuesi mund dhe duhej të kishte marrë dëmshpërblim nga prindërit e nxënësit që goditi djalin e tij. Megjithatë, fakti që kërkuesi mund të kishte ngritur një padi kundër prindërve të nxënësit tjetër nuk e ndryshon faktin që shteti nuk siguroi që shkollë të mund të mbajë përgjegjësi për dështimet e saj, në lidhje me dëmtimin e djalit të tij. Pretendimi i kërkuesit nuk është që për atë nuk u ofrua asnjë dëmshpërblim: përkundrazi, është se shteti dështoi në përmbushjen

e detyrimit të tij pozitiv për të siguruar ekzistencën e kornizave ligjore që do ta mbanin shkollën përgjegjëse për dëmin e shkaktuar nga një nxënës tek një tjetër.

Për ta mbyllur këtë pikë, edhe duke supozuar se neni 615 i Kodit Civil Shqiptar ishte një lloj ose – pjesë e një lloji – kuadri ligjor përkatës, meqë autoritetet kombëtare nuk ishin të përgatitura ta interpretonin dhe ta zbatonin atë në mënyrë që të ishte në përputhje me Konventën, dhe që në fund të fundit ato nuk e zbatuan atë në mënyrë efektive në çështjen në fjalë, rezultati përfundimtar do të ishte i njëjtë sikur të mos kishte fare kuadër ligjor. Për rrjedhojë, shteti i paditur nuk përmbushi detyrimet e tij pozitive, në lidhje me mbrojtjen e djalit të kërkuesit nëpërmjet ekzistencës së një kuadri ligjor efektiv.

8. Arsyeja e dytë pse detyrimet pozitive të shtetit të paditur konsiderohen të papërmbushura në çështjen në fjalë jepen në paragrafin 74, domethënë, që kërkuesi nuk ishte informuar menjëherë për incidentin nga autoritetet e shkollës. Ata as nuk kishin reaguar menjëherë për të siguruar që djali i kërkuesit të merrte trajtim shëndetësor të menjëhershëm.

9. Arsyeja e tretë për konstatimin e mospërmbushjes nga shteti i paditur i detyrimeve të tij pozitive, sipas nenit 8, jepet në paragrafin 77 të vendimit: mjeti juridik civil në dispozicion të kërkuesit në rrethanat e çështjes nuk ofronte mbrojtjen e duhur për djalin e tij kundër dëmtimit trupor. Gjithashtu, mënyra se si janë zbatuar mekanizmat ligjorë në rastin konkret ka qenë e mangët.

4. Konkluzion

10. Nisur nga ajo që është shpjeguar më sipër, si edhe në vetë vendimin, konkluzioni im është se ka pasur shkelje të nenit 8 nga shteti i paditur, për shkak të dështimit të tij për të përmbushur detyrimet e tij pozitive, në lidhje me incidentin ku djali i kërkuesit pësoi një dëmtrim të rëndë.



MENDIM PAKICE, PJESËRISHT I
PËRBASHKËT, I GJYQTARËVE PASTOR
VILANOVA, SCHUKKING DHE ROOSMA
(përkthim)

1. Gjykata, me shumicë votash, ka gjetur shkelje të nenit 8 të Konventës. Duke mos rënë dakord, ne kemi votuar kundër pikave 3 dhe 5 të dispozitivit të vendimit. Megjithatë, ne jemi dakord me shumicën për pikat e tjera në fjalë në këtë çështje të trishtë, që ka të bëjë me një incident në një shkollë private.

2. Faktet janë vërtetuar qartazi. Një nxënës trembëdhjetëvjeçar përdori një katapultë për të qëlluar me një objekt në syrin e djathtë të një nxënësi tjetër (djali i kërkuarit, i mitur njëmbëdhjetë vjeç në kohën në fjalë), duke shkaktuar pothuajse verbëri totale në atë sy. Ngjarja ka ndodhur teksa viktimja ishte duke ecur në ambientet e shkollës. Kërkuari ngriti padi civile kundër shkollës për dëmshpërblim, por nuk pati sukses. Më pas, ai paraqiti një ankim, i cili u rrëzua për arsyet e mëposhtme në veçanti: i. shkolla nuk kishte faj sepse incidenti kishte ndodhur jashtë mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë të mësuesve; ii. kërkuari duhej të kishte ngritur padi kundër prindërve të të miturit përgjegjës për incidentin ose kundër shoqërisë së sigurimit të shkollës; dhe iii. shiritat e llastikut në përdorim në institucion nuk ishin të ndaluara sipas rregullave të shkollës.

3. Shumica kanë arritur në përfundimin se shteti shqiptar kishte faj sepse gjykatat e brendshme nuk e shqyrtuan çështjen me kujdes (shihni paragrafët 73 dhe 74 të vendimit) dhe kështu nuk mbrojtën si duhej integritetin fizik të fëmijës që ishte viktimë (shihni paragrafin 77 të vendimit). Prandaj, është gjetur shkelje për shkak të shqyrtimit të pamjaftueshëm të incidentit nga gjykatat civile shqiptare.

Ne, me gjithë respektin, nuk pajtohemi me këtë përfundim për arsyet e mëposhtme.

4. Në kërkesën e tij, kërkuari parashtoi se gjykatat e brendshme nuk kishin përmbushur detyrimet e tyre pozitive për t'i dhënë atij kompensim (shihni paragrafin 64 të vendimit). Në dijeninë tonë, Konventa nuk ka garantuar kurrë një të drejtë për kompensim financiar për dëmin e shkaktuar si nga ashtu edhe ndaj personave private (në rastin konkret, një nxënës njëmbëdhjetëvjeçar dhe një nxënës trembëdhjetëvjeçar) të cilët nuk ushtrojnë asnjë funksion publik ose autoritet –

veçanërisht kur një dëm i tillë ka ndodhur në ambientet e një shkolle private.

5. Sipas paraqitjes së çështjes nga Gjykata në fazën e komunikimit, kërkuari pretendoi në kërkesën e tij se shteti nuk kishte arritur të mbikëqyrte një shkollë private të licencuar, e cila as nuk e kishte informuar menjëherë për dëmtimin e djalit të tij dhe as nuk i kishte dhënë fëmijës kujdesin e nevojshëm mjekësor. Me fjalë të tjera, ankesa e kërkuarit “duket” se ka të bëjë me dy elemente të veçanta: i. mungesa ose pamjaftueshmëria e një kuadri ligjor adekuat për të mbrojtur nxënësit e shkollave private nga aksidentet dhe për t'u siguruar atyre kujdes kur është e nevojshme; dhe ii. mosveprimi më pas nga autoritetet e shtetit.

Shumica ka përdorur dy argumente kryesore për të justifikuar gjetjen e shkeljes sipas nenit 8 të Konventës. Ata kanë shpjeguar se gjykatat e brendshme (gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit) nuk: i. analizuan arsyen pse nxënësit mbanin shiritat llastiku dhe katapultë përpara incidentit (shihni paragrafin 73 të vendimit); ose ii. nuk adresuan argumentin e kërkuarit që shkolla nuk e kishte informuar menjëherë për incidentin ose nuk kishte kërkuar trajtim për fëmijën e dëmtuar (shihni paragrafin 74 të vendimit).

Në fillim, ne kemi vështirësi thelbësore për të bërë lidhjen mes pretendimeve të kërkuarit siç janë paraqitur në kërkesën e tij – shumë shkurt në shikim të parë – dhe mënyrës se si shumica ka vendosur përfundimisht për çështjet “që i janë referuar” Gjykatës. Këtu mund të lindë problemi i pajtueshmërisë (shihni *Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë* [DHM], nr. 37685/10 dhe 22768/12, §§ 123 126, 20 mars 2018).

6. Edhe duke supozuar se shumica nuk ka vendosur *extra petita*, arsyetimi i tyre, i cili kryesisht konsiston në kritikën ndaj gjykatave civile vendase, që nuk mbrojtën si duhet integritetin fizik të viktimës, do të duket se anashkalon rregullat thelbësore të përgjegjësisë civile të përcaktuara nga procedura civile. Si rregull i përgjithshëm, paditësit i bie barra e provës të provojë dëmin e shkaktuar, me anë të provave. Prandaj, nuk është roli i zakonshëm i gjykatave civile të mbrojnë integritetin fizik të një të mituri – në rastin konkret nga një dëmtim i rëndë, përveç atij që përfshihet në objektin e nenit 8. Përkundrazi, funksioni i tyre është të gjykojnë sipas rregullave të një gjykimi të drejtë dhe në bazë të argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët në



mosmarrëveshje. Autoritetet, në fakt, morën disa hapa pas incidentit, megjithëse jo të mjaftueshme sipas kërkesit. Por një përgjigje e tillë nuk përbën në vetvete shkelje të Konventës. Më tej, mund të theksojmë se kërkuesi nuk i ka kërkuar më pas Ministrisë së Arsimit që të kryejë një hetim administrativ (shihni paragrafët 27 dhe 69 të vendimit).

7. Nga një këndvështrim tjetër, dëshirojmë të theksojmë se neni 615 i Kodit Civil Shqiptar parashikon përgjegjësinë e mësuesve për dëmet e shkaktuara ndaj të tjerëve nga një nxënës – me kusht që nxënësi në fjalë të jetë drejtpërdrejt nën mbikëqyrjen e tyre (shihni paragrafin 18 të vendimit). Kështu, gjykatat vendase duket se kanë zbatuar në mënyrë të arsyeshme ligjin vendas, sepse askush nuk e kundërshtoi faktin që incidenti kishte ndodhur ndërsa dy nxënësit ishin duke ecur në ambientet e shkollës së tyre private, me sa duket të pashoqëruar. Sidoqoftë, sipas ligjit të brendshëm përgjegjësia personale e mësuesve pa dyshim është objekt i mbikëqyrjes (aktuale) të drejtpërdrejtë mbi personin që ka shkaktuar dëmin, gjë që sipas gjykatave të brendshme nuk kishte ndodhur në çështjen në fjalë. Për më tepër, kërkuesi nuk e kundërshtoi zbatimin e kësaj dispozite ligjore. Gjykata ka theksuar vazhdimisht në praktikën e saj gjyqësore se nuk i takon asaj të zërë vendin e autoriteteve kombëtare nëse nuk ka arsye shumë bindëse për ta bërë këtë.

8. Për më tepër, në paragrafin 71 të vendimit lexon që një institucion arsimor është i detyruar të mbikëqyrë nxënësit gjatë të gjithë kohës që ata kalojnë nën kujdesin e tij. Vendimi vazhdon t'i referohet çështjes *Kayak kundër Turqisë* (nr. 60444/08, §§ 59–60, 10 korrik 2012, vendimi i miratuar me pesë vota pro dhe dy kundër), ku Gjykata konstatoi se misioni që i ishte besuar një institucioni arsimor “[përfshinte] një detyrë parësore për të garantuar sigurinë e nxënësve ... gjatë periudhës që ata qëndrojnë nën kujdesin e saj”. Më tej thuhet (*ibid*):

“[Edhe pse] nuk mund të pritët që stafi pedagogjik të mbikëqyrë çdo nxënës vazhdimisht në mënyrë që të reagojë në çast ndaj sjelljeve të paparashikueshme, Gjykata megjithatë vlerëson se disa lëvizje të nxënësve... kërkojnë mbikëqyrje më të ngushtë. I tillë është veçanërisht rasti për ... lëvizjet e nxënësve brenda [institucionit arsimor].”.

Ky detyrim i autoriteteve u kritikua ashpër në opinionet e veçanta të tre prej gjyqtarëve të Dhomës. Gjyqtarja Tulkens vuri në dukje në mendimin e saj paralel se detyrimi i përgjithshëm për të mbikëqyrur nuk mund të ishte absolut dhe përbënte një barrë të tepruar për autoritetet e shkollës. Po njësoj, dy gjyqtarët e mendimit të pakicës, gjyqtarët Sajó dhe Raimondi, vlerësuan se asnjë shtet, “sado paternalist, nuk [ishte] i aftë të kontrollonte të gjitha veprimet e ndërmarra nga qytetarët e tij”.

Sot, shumica ka përqafuar detyrimin e përgjithshëm për të mbikëqyrur të konsoliduar në *Kayak* – një zhvillim i jurisprudencës të cilin ne nuk e mbështesim domosdoshmërisht dhe që, në mungesë të një studimi të së drejtës krahasuese, nuk duket se bazohet në ndonjë konsensus evropian. Për më tepër, qëndrimi i paqartë i mbajtur në vendimin *Kayak* me sa duket është braktisur që atëherë (shihni *Derenik Mkrtchyan dhe Gayane Mkrtchyan kundër Armenisë*, nr. 69736/12, § 59, 30 nëntor 2021). Duket se kërkohet një sqarim i praktikës gjyqësore në këtë fushë.

Problemi është, gjithashtu, se arsyetimi i shumicës supozon – duke shpërfillur ligjin e brendshëm të zbatueshëm – se shtetet kanë një detyrim pozitiv sipas të cilit të gjitha institucioneve arsimore, private dhe publike u kërkohet të garantojnë sigurinë e nxënësve të tyre në çdo kohë dhe janë përgjegjëse për të treguar pamundësinë e tyre për të parandaluar çdo dëm që mund të ndodhë. Kjo përbën një prezumim të përgjegjësisë së shtetit për çdo incident që ndodh në një institucion arsimor – qoftë edhe privat. Ne vlerësojmë se, duke konfirmuar dhe madje duke zgjeruar *Kayak* (cituar më lart), Gjykata ka tejkaluar rolin e saj sepse, duke vepruar kështu, ka vënë në pikëpyetje rregullat e konsoliduara tashmë të detyrimit për dëmshpërblim, që ekzistojnë në shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës.

9. Për të qenë më të saktë, Gjykata e Apelit shpjegoi se shkolla nuk kishte mundur t'i ndalonte nxënësit të mbanin shirita llastiku dhe se autoritetet e shkollës nuk mund ta kishin parashikuar ndodhinë e incidentit (shihni paragrafin 9 të vendimit). Ky argument nuk duket i paarsyeshëm. Lidhur me trajtimin mjekësor, Gjykata e Apelit konstatoi se shkolla kishte ndërmarrë hapa pas incidentit (shihni paragrafin 9 të vendimit). Ne nuk jemi në pozitë të kundërshtojmë atë konstatim. Megjithatë, kërkuesi do t'i duhej të tregonte se trajtimi i shpejtë mjekësor



(ai çoi djalin e tij në spital 75 minuta pas incidentit) do të kishte shpëtuar syrin e dëmtuar. Kjo nuk është provuar. Në fund, çështja nuk është nëse gjykatat e brendshme e trajtuan faktin që katapultat ndodheshin në shkollë për disa ditë, por nëse vetë shkolla ishte në dijeni të këtij fakti. Përsëri, ne nuk e dimë nëse ky fakt është vërtetuar nga kërkuesi apo është pranuar nga shkolla.

10. Në fund, gjykatat e brendshme nuk e përjashtuan asnjëherë të drejtën për të kërkuar kompensim për dëmin e shkaktuar viktimës, sepse ata sugjeruan që të ngrihej një padi kundër prindërve të të miturit autor bazuar në prezumimin e sjelljes së paligjshme, në cilësinë e tyre si mbajtës të përgjegjësive prindërore (sipas nenit 613 të Kodit Civil). Megjithatë, nuk ka asgjë për të treguar që kërkuesi e ka ndjekur atë rrugë. Si rezultat, kërkuesi nuk e gjeti veten në një situatë mohimi të drejtësisë. Ai zgjodhi të ngrejë padi për dëmshpërblim kundër shkollës private të fëmijës së tij në gjykatat civile. Rrjedhimisht, tani nuk i takon shtetit të përballojë koston e një strategjie të dështuar procedurale dhe të marrë përsipër përgjegjësinë për pakujdesinë e një subjekti tërësisht privat.



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024



Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë